

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

85H-2  
P85

**STAVRI  
PONE**



**TE MOS  
KISHE  
DREMITUR**

**DRAMË**


821.985-2

P85

STAVRI PONE

# TË MOS KISHE DREMITUR

dramë në tri akte



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## P E R S O N A T

FILIP SHOLLA — mjek, punonjës në dikaster  
DHOQINA — e ëma  
VASILIKA — e shoqja  
ETLEVA — e bija, maturante stazhiere  
NORA — e bija, nxënëse e klasës së tetë  
TRIFONI — i vëllai  
LENA — gruaja e Trifonit  
LLUKË KARAKOLLI — kooperativist  
PETRITI — mjek, punonjës në dikaster  
HYSENI — kryetar dege  
MARIA — shoqe e Dhoqinës  
DRITA — mësuese  
NËPUNËSI  
MËHILLI — mjek, punonjës në bazë  
GRUAJA  
*I DËRGUARI NGA RRETHI*

Ngjarjet zhvillohen në ditët tonë.

## AKTI I PARË

### Tabloja e parë

Dhomë e një shtëpie dykatëshe fshati. Në të djathët oxhaku, me sergjene anash, ku duken disa orendi kuzhine. Mbi oxhak portreti i një plaku mustaqelli, hijerëndë e krenar. Përballë minderi, mbi të një çifte dhe një pushkë e vjetër, të kryqëzuara. Mbi to varet portreti i një djaloshi të ri partizan. Në anën tjetër bufeja, televizori, radioja. Në mes një tavolinë kuzhine, mbi të një vazo me kaktus.

Ndihet shija, pastërtia dhe rregulli. Gjithçka flet për një shartim origjinal të atmosferës së kohës së kaluar dhe të kohës sonë.

Hyjnë Vasilika, Filipi, Drita.

DRITA. Ja, këtu ka zbritur gjyshja tani. I pëlqen të banojë në këtë dhomë.

VASILIKA. Paska bërë ndryshime. (*Vështron rrotull.*) Posi, pos... E kemi plakë me shije nënën.

Filipi shkon te oxhaku e ndalet para portretit të plakut.

Faleminderit, moj vajzë. Po s'na the, nga të kemi?

DRITA. Nga Korça.

VASILIKA. Dhe ke ardhur tē punosh vullnetarisht si mësuese këtu?

DRITA. Po.

VASILIKA. Shumë mirë, shumë mirë. Po me vajzën tonë, me Etlevën, nga njihesh?

DRITA. Që parvjet, kur erdhi si aksioniste këtu. Pastaj, Etleva këtu i kaloi edhe pushimet. Ajo tha se do tē vinit edhe ju...

VASILIKA. E, shkuam në Durrës.

FILIPI (*portretit*) Eh, baba, baba! (*Vështron rrrotull*.) Moj shtëpizë e dashur... (*Shkon te dritarja*.) Ja, kaq sa një cërr isha kur shikoja nga dritarja var-kën e babait që nisej pér tē peshkuar. Ja ulliri, atje tej, po ai, vëtëm limonat janë vënë më vonë. Eh, shtëpi, shtëpi!... (*Shkon te minderi, ulet*.)

Drita rri si mbi gjemba, s'di ç'të bëjë.

VASILIKA (*Dritës*). Po mirë, s'tha gjë nëna kur iku?

DRITA. Jo. Na la çelësin e dhomës, se... ne s'kemi televizor. Kur mori telegramin tuaj, tha se do tē priste sa tē vinit, pastaj do tē shkonte tek Agroni, mirëpo iu kthyë mendja dhe u nis pér në Peshkopi.

VASILIKA (*Dritës*). Po pse shkoi, tha gjë?

DRITA. Tha se e kishte marrë malli pér djalin e Agronit. E kishte parë në ëndërr.

FILIPI. Ajo s'ka qenë as supersticioze!

VASILIKA. Tha se kur do tē kthehet?

DRITA. Pas nja dy javësh. Të vete më mirë tani në vjeshtë, tha, se më vonë zihen rrugët nga dëbora.

VASILIKA. Po ti me kë banon atje lart?

DRITA. Me një shoqe tjetër. Gjyshja vetë na i la tē dyja dhomat. Neve edhe njëra na mjafton.

VASILIKА (i vjen inat). Epo, domosdo! Gjersa jeni brenda, ju ka bërë si të shtëpisë.

DRITA. Mua do të më falni. Po të keni ndonjë nevojë, më thërrisni.

VASILIKА. Mirë, mirë. Faleminderit. (Ulet në karrige.)

Drita dei. Filipi dhe Vasilika rrinë për disa çaste të heshtur.

Pas pak Filipi ngrihet dhe hap televizorin.

(Nervoze.) Mbylle atë, Filip. Më mirë të mendojmë ç'do të bëjmë! (Pauzë.) I dërgojmë telegram, i themi po vijmë, ajo kërcet e ikën.

FILIPI. Kushedi si është puna, se nëna e di që një ditë do të pajtohem.

VASILIKА. Patjetër, do të pajtoheni! Djali kthehet një ditë dhe kokulur i kërkon falje nënës fisnike! (Pauzë.) Kaq herë të kisha thënë: shko atje, në fshat, t'i kërkosh të falur. (Me zë qortues.) Po ti e shtyje dhe prisje rastin kur nëna të vinte te yt vëlla, te Trifoni. (Merr valixhen, e vë mbi tavolinë, e hap.) Po tani, ç't'i bëjmë kësaj? (Nxjerr një copë stof.) Stof si ky s'gjen gjékundi. E kisha ruajtur për nënën time, po ja që m'u desh t'ia bëj peshqesh vjehrrës. (E tund.) Ç't'i bëjmë tani? (E përplas në valixhe.) Ç'na bëre, more Filip!

FILIPI. O, na lodhe! Kur të vijë në Tiranë, jepja.

VASILIKА (ankuese). Po ku i dihet ç'ka bërë me shtëpinë? S'duhet humbur kohë, jo! Po sikur vërtet t'ia ketë dhënë fjalen ndonjërit për ta shitur? (Me hidhërim.) Nga vajtëm e u zumë me Agronin... Punën në Tiranë ia gjete si jo më mirë. Mjek i specializuar, djali i ri, me të ardhmen përpara... (Me ton të lartë.) Po s'deshi djali ynë të rrinte në Tiranë... Ama,

dhe ne i thamë: s'do të rrish? Qafën thyej, nga sytë këmbët...

FILIPI. Mos e tepro, se nuk ia tha njeri këto fjalë Agronit!

VASILIKA. Ia thamë që ç'ke me të. E na zemë-rohet nëna jote e nderuar e na i del krah... (*Ul zë-rin.*) Po, me sa ma ha mendja mua, ajo shkak për t'u zënë donte...

FILIPI (*ashpër.*) Nëna s'e ka zakon të zihet me njerëzit.

VASILIKA. Donte shkak për t'u zënë! Pa ç'iu prish puna plakës se ku do të punonte i nipi?

FILIPI (*prerë*). Ti e di inatin e vjetër...

VASILIKA. I mblođhi të tëra bashkë nëna jote. Vinte e na jepte mend: le të marrë djali kë të dojë... Të dashurohej djali e të martohej me kë t'i donte qejfi, pa nëna e babai në dreq të venin...

FILIPI. Epo, mjaft tani! Ja që ashtu u bë, ai mori atë që deshi dhe ne s'patëm ç't'i bënim.

VASILIKA. S'ka pse të na komandojë...

FILIPI (*me zë të tendosur*). Po një mendim do ta thotë, apo jo? E shtëpisë është, nuk është e huaj.

VASILIKA. Mirë, mirë, mos bërtit. (*Ngrihet, shkon te bufeja.*) Ç'thua, do të hamë ndonjë kafshatë?

FILIPI. Nuk më hahet, jo.

Vasilika nxjerr nga dollapi ushqime dhe i vë mbi tavolinë.

Filipi bredh lart e poshtë nëpër dhomë.

VASILIKA (*sikur nguroset në vend*). S'më hiqet nga mendja...

FILIPI. Çfarë?

VASILIKA. Shtëpia... Kur i afroheshim fshatit, e shikoja nga maja e kodrës. Si në përrallë... kaq

hijerëndë dhe e bukur, e fshehur në mes të pemëve, ashtu, në errësirë... (*Pauzë.*) Si kështjellë... E gjitha me gurë, kopsht, limona e portokalle, dyqind metra larg detit, në këtë goxha fshat të Rivierës... E shikoja nga maja e kodrës e më pikonte në zemër kur mendoja...

FILIPI (*i qetë*). Nuk shitet kollaj kjo shtëpi, jo!

VASILIKA. Ou?! Kjo është thesar, ta rrëmbejnë nga dora, ti më thua... Kot s'qenë ato fjalë që dëgjuam te yt vëlla. Ato fjalë na bënë të marrim gjithë këtë rrugë... (*Pauzë.*) Plaka mund ta shesë, mund të bëjë q'të dojë. Ja e shiti. Ç'ju bien juve, tre fëmijëve të tjerë? Hiçgjë s'ju bie. Më të shumtë Trifoni ka për t'i marrë, se, me sa duket, tek ai do të rrijet nëna jote.

Filipi *ngrihet*, shkon te dritarja, vështron *jashtë*.

Kurse shtëpisë, sa më shumë kohë të kalojë, aq më tepër i rritet vlera. (*shikon muret me vëmendje.*) Nesër ditën e shohim mos i duhet bërë ndonjë meremetim. (*Në ankth.*) Ah, more Filip! Po thuamë, mos ia ka dhënë fjalën ndokujt për ta shitur?

FILIPI. Po di gjë unë? Nesër pyesim dhe e marrim vesh.

VASILIKA. Nuk bën të pyesim botën. Po thuaj që, apo të vijë në Tiranë, t'ia kthejmë mendjen, po qe se ka vendosur. Se shtëpia na duhet, dimër, verë. Edhe me qira lëshojmë ndonjë dhomë, edhe ullinj e portokalle sigurojmë. Kur e kemi, përsë të mos e mbajmë? Plaka me sot e me nesër është, kurse ne... (*E pikëlluar.*) Gjithë kjo rrugë!

FILIPI. E morëm vesh tanë! (*Mban vesh.*) Kush vjen kështu?

Hyn Maria, një plakë e trashë, gazmore, e mbajtur mirë. U hedh nga një vështrim të shpejtë Vasilikës e Filipit.

MARIA. Ou, kush na paska ardhur! (*Shkon te Filipi.*) Ç'të kthejmë pér së mbari, more shoku doktor nga Tirana? (*I jep dorën.*)

FILIFI. Ku je, moj Marie luanesha!

MARIA (*kthehet nga Vasilika*). Mirë se na erdhe, moj nusja jonë! (*E puth.*) Akoma atje punon, me kartrat?

VASILIKÀ. Jam shefe e kartotekës, moj Marie! (*Me tjetër ton.*) Po vërtet luaneshë qenke, ta paska frikën pleqëria.

MARIA (*ulet në minder*). Përse të plakem? Gjithë të mirat i kam. Unë dhe nëna juaj kemi vendosur të mos plakemi. Po si kaloni, si jeni andej? Etleva mirë është? Kanakarja e gjyshes. E keni nga Dhoqina vajzën, ua mbajti e ua shëndoshi plot gjashtë vjet, që nga e treta e fillores e gjer në të tetën. Zemra i dhemb që s'e ka këtu. Ç'vajzë që keni, ç'vajzë... (*Vasilikës, që pregatit darkën.*) Rri ti, Vasilikë, se je lodhur. (*Ngrihet ta ndihmojë.*)

VASILIKÀ. Mbarova, s'ka gjë.

MARIA. Po me nënën u ngrohët ndopak? Se është kockë e fortë Dhoqina.

VASILIKÀ. S'jemi ftohur, moj Marie, njerëzit tanë jemi. Yti mishin e ha, po kockën ta ruan.

MARIA. Ashtu është, bijë e nënës. (*Pauzë.*) Mora vesh pér ju e ardhsh. Po kam dhe një hall.

VASILIKÀ. Ç'hall?

MARIA (*kthehet nga Filipi*). Kam nipin e vogël pa qejf, o Filip. As motin nuk ka mbushur. E vizitoi nusja te doktori ynë, po ai është i ri. T'u bëftë Maria, shihe njëherë ti, se ti je doktor e shkuar doktorit.

FILIPI. Doktor jam vërtet, po punoj në ministri.  
MARIA. E ç'bëri ajo? Shikoje njëherë.

FILIPI (*zihet ngushtë*). Unë s'jam as për kala-maj...

MARIA (*ngrihet*). Për njerëz je, nuk je për kaf-shë, de!

FILIPI. Jo, për kafshë s'jam, xhanëm, po s'kam as veglat...

MARIA. Ç'vegla? Mos ke bark për të çarë? Djali ka zjarr e vjell. Shikoje edhe ti, të mbledh mendjen.

VASILIKА. Bjere, moj Marie.

MARIA. Tani vij. (*Del.*)

FILIPI. Ç'bëre? S'e di që këta dy vjetët e fundit kam vizituar a s'kam vizituar pesë-gjashtë njerëz?

VASILIKА. Po s'ia shikove, i mbetet qejfi. Kur ta kemi shtëpinë pa zot këtu, kush do të kujdeset?

FILIPI. Po s'kam as receta, djalli ta hajë!

VASILIKА. More, po bëja qejfin asaj! (*Shkon te bufeja; anash saj i zënë sytë një shishe me vaj plazhi.*) Po kjo? (*E merr në dorë.*) Vaj plazhi... I kujt do të jetë?

FILIPI. Ç'ke me të? Mbase e çupave atje lart. (*Shëtit i menduar nëpër dhomë.*)

VASILIKА (*e menduar*). Vera e dytë që s'vijmë këtu... (*Papritur.*) Nga shkaku i tekave të riënës sate shpenzuam dynjanë në Durrës! (*E hedh shishen pa kujdes.*)

FILIPI (*ashpër*). Mbase s'qenë vetëm tekat e në-nës ato, po mjaft tani. (*Ngrihet, shkon te bufeja, merr një shishe verë.*)

VASILIKА. Mos pi. Do të të zëjë koka.

FILIPI. Një gotë s'më bën gjë.

VASILIKА (*ulet në karrige*). Do të hamë, apo do t'i shikosh qunin njëherë?

Dëgjohen hapa t  r nd .

FILIPI. Ja, po vjen.

Hyn Lluk  Karakolli, nj  burr  rreth t  pes dhjetave, i p rruar, me fytyr  t  qeshur. Sa hyn n  der , q ndron pa l vizur.

LLUKA. Sht pia plot, brenda pa zot. Erdh n miqt , po ku jan  fiqt ?

FILIPI. Ku je, Lluk  Karakolli, ku je! (*I sulet, e p rqafon, do ta t rheq  me vete, po ai s'luan.*)

LLUKA. Takohen zonjat m  par . (*Vasilik s.*) Pse s'm  flet, zonj  e sht pis , mos t'u dogj fundi i kusis ?

VASILIKA (*qesh me zor.*) Urdh ro, Lluk  shaxhiu. M  fal, se jam e z n , po b j sallat n. Ulu.

LLUKA. Ku kan  urdh ruar nj  pal , urdh rojn  edhe dy. Kur zbretn kryeqyteti n  fshat, fshati b het kryeqytet. E shikon mallin me mall, po malli i madh t  shtie n  hall... (*L viz ngadal  n p r dho-m .*)

VASILIKA (*e kupton thumbin.*). Ku e ke fjal n ti, Lluk ?

LLUKA. Ju ka z n  malli, them. (*B n nj  rreth me dor .*) Dy vjet pa ardhur... Q kcur vdiq plaku,  ?

FILIPI. Plaku po b n tre vjet, o Lluk .

LLUKA. Si  sht  Etleva?

VASILIKA. Shum  mir . T  b n t  fala.

LLUKA.  up  e daj s... Fis e gj  s'jemi, po ajo daj  m  th rret. Thash  mos kishte ardhur Trifoni, se kisha pak pun  me t . Ika. (*B n t  dal .*)

FILIPI. Si je tan , more Lluk ?

LLUKA (*ndalet*). Mir  fare, o Lipe. Punoj n  kopshtin eksperimental, brigadier. Sa erdhi kryetari

i ri, më vuri në punë, atje ku isha. Xhevahir burrë eshtë. Po ai që ishte para këtij, ai që erdhi në këmbë të Trifonit, pa-pa-pa... vetëm për llafe. Ai më nxori nga puna, më solli vërdallë. Ky kryetari eshtë burrë... E kam zanat agronomllékun, o Filip. Doktori s'donte, thoshte të shërohesha mirë, po pastaj pranoi. (*Shkon te dera, qëndron, kthehet, shkon mbush një gotë verë.*) Po kryetar si Trifoni s'gjen. Për gëzime e për të mira! (*E kthen.*)

FILIPI. Rri të hamë darkë.

LLUKA. Faleminderit, po s'rri dot. Kam ca fidana të rinj dhe trembem mos bëjë ngricë natën, ndaj shkoj t'i mbuloj. I kam si fëmijë, o Filip. Edhe fidana merr të ftohur, vetëm se s'ka gojë të thotë. Qofshi me shëndet! (*Del.*)

FILIPI. Qenka fare mirë tani.

VASILIKA. Asgjë s'ka ai. Shpo këtu e shpo atje ka qenë gjithnjë.

FILIPI. Zemrën e ka flori, ama. Kur ra nga kali, pësoi një traumë, po mendjen e ka top.

Hyn Maria me foshnjën që fle.

MARIA. Ç'thoshte Lluka? (*Lë foshnjën mbi minder.*)

FILIPI. Lluka si Lluka! (*Përkulet mbi foshnjën, e sheh me vëmendje në fytyrë.*)

Maria e ndihmon ta zhveshë.

MARIA. I dhashë ilaçin dhe u pllakos. Ka kaq net që s'fle.

VASILIKA (*përkulet mbi foshnjën*). Neuk, neuk! Si pëllumb qenka!

FILIPI (*vë veshin mbi kraharorin e foshnjës*).  
Digjet... Sa e kishte temperaturën?

MARIA. E ku di gjë unë, a të keqen nëna.

FILIPI (*s'di ç'të bëjë; pas një pauze*). Sa herë në ditë del jashtë?

MARIA. Ku i merret vesh këtij, o Filip!

FILIPI (*e kthen përblys, i bie me gisht në kurri. Foshnja zgjohet e fillon të qajë*). S'ka të ftohur. Çështje barku është. E ka të mirë gjirin nusja?

MARIA. Pse jo?! (*Nxjerr nga xhepi një kuti të vogël kartoni dhe ia tregon*.) Ja, këto i ka dhënë.

FILIPI (*i sheh*). Penicilinat për bark nuk shkojnë. Po... (*mendohet*) në raste ekstreme edhe shkojnë. Mjeku ka gjetur rrugën optimale.

MARIA (*shqetësohet*). Ç'ka gjetur? Gjë me rrezik është?

FILIPI. Jo shumë. Do t'i shkruaj një recetë tjetër, më të fortë. Puna është që foshnja të jetë brenda...

MARIA. Jashtë s'e nxjerr unë.

FILIPI (*kërkon nëpër xhepa*). S'paskam as stilografin!

MARIA. Të sjell penën e çupës?

FILIPI (*pasi mendohet*). S'ka nevojë, mirë janë edhe këto. Kujdes në ushqim, për asgjë tjetër të mos bëheni merak.

MARIA (*rregullon foshnjën, e merr në duar*). Faleminderit! Po të keni nevojë për gjë, më thërrisni. (*Nxjerr nga trasta një vazo të madhe; Vasilikës*). Merrini këto. Ca ullinj kam vënë.

FILIPI (*i mban dorën*). Ç'është ajo?! Në asnje mënyrë!

Vasilika ia bën me shenjë, po ai s'e vë re.

MARIA. S'i prura si pagesë pér vizitën, de! Merrini, merrini!

VASILIKА. Meqë po ngul këmbë... (*Ia merr vazon dhe e lë mbi tavolinë.*)

MARIA (*bëhet gati të dalë, vë re shishen*). Pökëtë shishe me vaj plazhi të Dhoqinës ç'e keni nxjerrë këtu?

VASILIKА (*e habitur*). E nënës është?

MARIA. Unë dhe Dhoqina rrimë anës detit, shtrihemi në rërë. E patëm pak zor në fillim, po u mësuam. Na bën mirë pér reumatizëm.

FILIPI (*qesh*). More, more... Mos shkoni edhe nëpër mbrëmje vallëzimi?

MARIA. Edhe atje shkojmë, kur na thérresin të rinjtë. Dhoqinës i thonë merrja njëherë si qëmoti dhe ajo s'ia përton, e heq vallen pér bukuri. Ika, natën e mirë! (*Ndalet.*) Harrova, keni të fala nga Kasëm Qelibari.

VASILIKА. Ç'është ky Kasëm Qelibari?

MARIA. Ai që do të blejë shtëpinë.

VASILIKА (*ngrin në vend*). Shtëpinë tonë?!

MARIA (*habititet*). Ju e dini, apo s'e dini që Dhoqina do ta shesë shtëpinë?

FILIPI (*me zor*). Një farë soj... Edhe e dimë, edhe s'e dimë. Domethënë nuk dinim se kujt do t'ia shesë.

VASILIKА (*e mpirë, Filipit*). Filip... (*Maries.*) E dimë, moj Marie, po... se si të vjen kur e merr vesh se kush do ta blejë. Ta tha vetë nëna?

MARIA. Këtë e dinë të gjithë. Me fat Kasemi... Të pakta janë shtëpitë si kjo. Nesër do të vijë t'ju takojë vetë. I martohet djali dhe do zgjerim. Ai po enget punën, po Dhoqinës s'i bëhet të ikë... Ajo te djali do vejë, xhanëm, po unë... (*E pikëlluar.*) Si do

bëj unë pa të, si do bëj! (*Fshin lotët.*) Ika, natën e mirë! (*Del*).

FILIPI. Natën e mirë!

Vasilika del ta përcjellë, po shtanget te dera, s'i bëjnë këmbët. Qëndron disa çaste ashtu, pastaj hyn në dhomë me vrull e pérplaset në minder. Filipi ulet në karrige e mbush një gotë verë.

VASILIKА (*ngre kokën, pérplas duart*). Filip, na iku shtëpia! (*Ngrihet, sytë i mbushen me lotë.*) Dëgjon ç'të them?

FILIPI (*që t'i japë zemër*). Nuk e dimë si është puna. Ai mund t'i ketë hedhur ndonjë llaf dhe nëna...

VASILIKА (*me forcë*). Jo, jo. Gënjen veten. (*Ul tonin, vajtueshëm.*) Mbaroi, mori fund... (*Qan, shkon te dritarja.*) Endrra jonë... (*Kthehet, i afrohet Filipit.*) Ç'më pi verë?! Po e feston? Hajde, t'ia marrim këngës... Të kujtojmë ditën e dasmës sonë. (*I rrëmbejn gotën nga dora.*) Ta pimë pér njëzetepesëvjetorin e martesës... Ja, në këtë dhomë u myllëm natën e parë... Të pimë, ta festojmë, se pas njëzet e pesë vjetësh edhe kjo shtëpi... (*Pérplas gotën.*) Ç'më vështron ashtu?

FILIPI (*ngrihet i inatosur*). U çmende??!

VASILIKА. Doje të mbaje mëri... (*Pérplas këmbën.*) Jo, s'do ta lëmë. (*Me ton lutës.*) Filip, ç'do të bëjmë? Fol, të lutet gruaja jote. Po na afrohen vitet e pleqërisë... Si mund të ndahemi nga kjo shtëpi? Të ishte gjallë yt atë, kurrë s'do ta bënte...

FILIPI (*i menduar*). Do të përpinqemi t'ia kthejmë mendjen nënës, po mjaft.

VASILIKА. Sikur m'u këput një copë nga zemra...

FILIPI. Mjaft, tani! Po bën sikur na ka vdekur njeri. (*Me forcë.*) Qysh nuk më qorton që e gënjeva atë plakë? Që nuk guxova ta vizitoja atë foshnjë?...

VASILIKA. S'ke atë punë ti tani, po lëre. Eja vër një kafshatë në gojë.

FILIPI. Lërmë me gjithë kafshatë, Vasilikë. (*Shëtit me nxitim; më tepër me vete.*) Shkëputu e shkëputu nga vizitat, dashur pa dashur, vjen një ko-hë që veshi të lë e dora të dridhet.... S'ke guxim, e pikë.

VASILIKA. More Filip, pse nuk vret më mirë mendjen pér hallin e shtëpisë?


FILIPI. A, kjo s'qenka pér të vrarë mendjen?! (*Pauzë e shkurtër.*) Po edhe një student do të ishte tallur me mua!

VASILIKA. Dëgjo, që nesër të vemi te Trifoni. Sa të zgresim nga makina.

FILIPI (*i lodhur*). Mirë, Vasilikë, mirë... Zakon i vjetër ky; fyellit në një vrimë! (*Shkon te dritarja.*)

VASILIKA (*pérplas një pjatë.*) Jo, po do merrem me èndrra!

FILIPI. Me èndrra? (*E shikon gjatë, ashpër.*) Në qoftë se keqardhja pér humbjen èshtë èndërr, atëherë... ç'èshtë vetë humbja? È? (*Vështron jashtë.*) Se keqardhjen, si e ndien, ashtu dhe e harron, tamam si èndrrën... (*Kthehet nga Vasilika.*) Po humbjen? Apo më mirë të mbyllësh sytë para saj. Kështu thua ti? (*Me forcë.*) Mbylli sa të duash, ajo të del se të del përpara! Ajo èshtë realitet, një realitet që të shtrëngon si darë... (*Hidhur.*) Po, natyrisht, kur i nën-shtrohesh, fillon e të pëlqen, pajtohesh... Koha kalon dhe më vështirë e ke ta shkundësh... (*Vendos dorën në shtalkën e dritares.*) Po, ke të drejtë, grua, këto janë èndrra tani... (*E mbledh veten, kthehet nga e*



*shoqja.)* Mos u mërzit, se do të shkoj te Trifoni, do të shkoj!

### Tabloja e dytë

Dhomë pritjeje e apartamentit të Filipit, në Tiranë. Në të majtë një pjesë e korridorit, ku duken dyert e dhomave të tjera. Në një cep të korridorit, pranë një rafti të madh të mbushur me libra, një tavolinë e vogël, mbi të cilën është vendosur telefon. Nëpër të gjithë ambientin çdo gjë flet për shije e sqimë. Mbrëmje. Filipi, Vasilika dhe Nora janë duke parë një film në televizor.

FILIPI. Ja dhe filmi mbaroi. (*Kthehet nga e shoqja; atë e ka zënë gjumi, mbështetur në divan; sheh Norën, edhe ajo ia ka këputur gjumit në kolltuk.*) Hajde, hajde! (*Shkon fik televizorin, i afrohet Norës.*) Nora, çohu, të keqen babi, shko matanë.

Nora gati lëshohet, Filipi e mbërthen mirë dhe eçon matanë. Kthehet, ecën deri në mes të dhomës, shikon nga e shoqja.

VASILIKА (*zgjohet*). Sa shkoi ora kështu? Erdhi vajza?

FILIPI. Vjen tani, vjen.

VASILIKА (*gogësin*). Lena telefonoi?

FILIPI. Jo. Po s'kthehet Trifoni sonte, hiqe nga mendja. Edhe në qoftë se vjen, do të jetë i lodhur, s'ka këmbë të vijë deri këtu.

VASILIKА (*shfryn*). Epo, të rrijë dy javë me shërbim tjetri! Ç'deshi që erdhi fare në ministri? (*Mban vesh.*) Pa prit! Vajza, dëgjoj hapa.

Të dy mbajnë fryshtë. Hyn Trifoni, një burrë i gjatë, i qetë,  
pak i lodhur.

FILIPI. Pa shih, Trifoni!

TRIFONI. Mirëmbrëmani!

VASILIKА (*gjithë mirësjellje, i del përpara*).  
Humbe, more Trifon, humbe... Bëre merak edhe njerëzit e shtëpisë. (*I jep dorën i tregon kolltukun.*) Ur-dhëro!

FILIPI (*duke e përqafuar*). Si kalove?

TRIFONI. Mirë fare. (*Vasilikës.*) Kështu e patë  
punën, moj ti, kunatë.

FILIPI. More, po u bëmë merak! Pothuaj çdo  
ditë i telefonoja Lenës. «Erdhi? Kur do të vijë?» Po  
ç'pate? Sikur për tri ditë e kishe, apo jo? (*Ulet.*)

TRIFONI (*ulet*). Për aq e kisha, por ja që m'u  
deshën dy javë. Kanë halle njerëzit, vëlla! Duhen  
ndihmuar. Të gjitha punët nuk zgjidhen me telefon.

Vasilika sjell cigare, ia zgjat Trifonit.

FILIPI (*Vasilikës*). Na sill nga një gotë ti, grua!  
VASILIKА. Ja, tani.

FILIPI (*Trifonit*). Kot u mundove tani... I thashë  
Lenës, po të vije deri nga ora nëntë, më telefono.

TRIFONI. Ajo s'më la as të ulesha: shko tek ata,  
se kanë tërë javën që pyesin. Si është puna? I lo-  
dhur isha, po s'më rrihej pa e marr vesh.

FILIPI. Do të llafosemi, do të llafosemi... (*Vasi-  
likës.*) Sille shishen. (*Trifonit.*) Hedhim nja dy gota,  
kam raki të mirë. Hajt, se të çlodh.

TRIFONI. Mirë, s'po ta prish. (*Ul zërin.*) Si është  
puna? Etleva?...

Vasilika shtron tavolinën me mjaft shkathësi.

FILIPI. Jo, jo... Puna e saj mbaroi. U rregullua me të.

TRIFONI (*habitet*). Si?!

FILIPI (*qesh me zor*). Ç'pate?! Ja që iu kthyë mendja.

TRIFONI. Iu kthyë mendja?!

VASILIKA. Hajde Filip! Urdhëro, Trifon!

FILIPI (*pak i shqetësuar*). Të thuash të drejtën, edhe ne s'ë prisnim...

TRIFONI (*i tronditetur*). Ç'ke bërë, Filip! Ajo sa s'qante vetëm kur ia zije në gojë... Sikur dhe fjalën se do ta lije të qetë, të vendoste vetë.

VASILIKA. Vetë vendosi, vetë.

FILIPI (*zë vend në tavolinë, pak nervoz, Vasili-kës*). Sill ato ngjalat që futa në sobë. (*I mbush gotën Trifonit.*)

TRIFONI. Po ku është tani?

FILIPI. Me të. Ka dalë. Hajt, gëzuar!

TRIFONI. (*me inat*). Ç'gëzuar?! Ajo është fëmijë! Kështu e mbajte fjalën?

FILIPI. Po e bëri vetë, o Trifon. Pastaj, fëmijë s'është, i mbushi nëntëmbëdhjetë vjeç.

TRIFONI. Ç'është kjo punë kështu?! Jeton me kohën ti, apo s'jeton? (*Shtyn gotën*). Më shtron dhe për të pirë... (*Ashpér*.) Me kë do të pi, që ta marr vesh: me vëllanë tim, apo me mblesin e mbesës sime?

Vasilika bën një lëvizje të vrullshme, diç do të thotë, po e mban veten.

FILIPI. Ç'janë këto fjalë, Trifon?!

TRIFONI. Është e dyta herë kjo! Jo, byrazer, jo... Mos i bëj hesapet e tua mbi kurrizin e fëmijëve. Sikur s'qe mjaft historia me Agronin...

VASILIKА. Ne bëjmë ato hesape që bën çdo prind.

FILIPI. Ç'hesape po bëj unë? Ç'hyn këtu Agroni? (*Ngre zërin.*) Ç'thuá ti, të mos i këshillojmë fëmijët, të mos i orientojmë? Ç'thuá ti, të livadhisë vajza si të dojë?

TRIFONI. Ta këshillosh po, po jo t'i japësh për burrë atë që do ti!

VASILIKА (*shpejt*). Po jo... Vajza këtu është, more Trifon, ti pyete vetë.

TRIFONI. Turp të ketë dhe ajo, po qe se vërtet ka pranuar! Se ma lëshonte kaq kokrrën e lotit! Se më vinte çdo ditë e më qante hallin: xhaxhi Trifon, thuaju atyre... xhaxhi Trifon, unë s'e dua, po ata ngulin këmbë... Turp të ketë! (*Bëhet gati të ngrihet.*)

FILIPI (*shpejt*). Prit, o Trifon, prit! Sa u rrëmbeve, o derëbardhë. Se mos i bëmë presion. I thamë vetëm të mendohej. Martesa llogari është, po t'i interesonte... (*Butë.*) Po s'është dhe djalë i keq Abdullai... Ç'ke që rrëmbehesh kaq shumë?

TRIFONI. Mor, po ajo as e njeh! Me ç'kam dëgjuar, dhe ai hundëpërpjetë është, si i ungji, Hyseni, që e mban veten sikur të ishte perëndia i mjekësisë botërore.

FILIPI. S'është i atillë Hyseni, jo. Duhet ta njo'hësh nga afër tjetrin që të flasësh... (*Shpenguar.*) Ktheje një, de! (*Ngre gotën.*)

TRIFONI. (*shtyn gotën me inat*). Sonte nuk pi. Nesër mbrëma më ke këtu, t'ia shtrojmë që ç'ke me të, po qe se ime mbesë më thotë: «Xhaxhi, unë e dua atë, uromë!» Kështu. (*Gati me ton të ashpër.*)

Po ç'kishe që më thirre? Për të më dhënë sihariqin?

Filipi diç do të thotë, po e mban veten me zor.

FILIPI (*pa gjallëri, si i vrarë*). Para dy javësh shkuam në Breg. Nënën s'e takuam, kishte shkuar tek im bir, në Peshkop. (*Mendohet*) Ti e di mosmarrëveshjet e mia me nënën. Mendova se... s'është mi-rë të vazhdojmë kështu.

TRIFONI. Unë i kam bërë të gjitha përpjekjet. Po ti ia di kokën nënës.

FILIPI. Shkuam të pajtoheshim, po atje marrim vesh se na paska dhënë fjalën për ta shitur shtëpinë...

TRIFONI. Mirë ka bërë. Ç'të rrrijë atje, vetëm?

VASILIKA (*ndërhyr*). E pse duhet shitur patjetër?

TRIFONI. Po edhe mund të mos shitet. Bile unë për këtë jam, të mos e shesim fare.

FILIPI. Po ashtu fol, de!

VASILIKA (*që nuk nxitohet*). Domethënë ta mbajmë?

TRIFONI. More s'po ju marr vesh. Ç'është kjo «ta mbajmë»? Po iku nëna, s'kemi si e mbajmë shtëpinë. Prandaj t'ia japim fshatit, e pikë. U duhet njerëzve atje.

Vasilika dhe Filipi shikojnë njëri-tjetrin në sy.

FILIPI. Hajde, vëlla, hajde! Ta japim falur thua, ë? (*Qesh*) Posi, posi... Tamam, ndërgjegje sociale...

TRIFONI (*nxehet, po e mban veten*). Mos më fol me këtë gjuhë, Filip! Unë kështu them. Nëna të bëjë si të dojë.

FILIPI (*pak me inat*). Këto idera sikur s'hyjnë këtu, Trifon!

VASILIKА (*prerë*). Nëna le të vijë në Tiranë, po nga fshati të mos çregjistrohet, dhe shtëpia mirë s'është atje ku s'është.

TRIFONI. Si të mos çregjistrohet?

FILIPI (*shpejt*). Po të rrijë, xhanëm... dy-tre muaj në behar, sa për ta mbajtur shtëpinë hapur...

TRIFONI. Poo... sa për të justifikuar mbajtjen. Po ç'ta duam shtëpinë?

FILIPI. E pse s'e dashkemi? Në breg të detitë s'është. Vjen behari, shkojmë të pushojmë.

TRIFONI (*habitët*). Ta mbajmë mbyllur një vit të tërë, për dy javë behar?

VASILIKА. Pse për dy javë?

FILIPI. Pse nxitohesh, Trifon! Je më i madh se unë e të takon t'i marrësh gjërat shtruar. Dy javë na duhet neve, dy javë ty, fëmijëve të tu, Etlevës, motravë tonë... Pak jemi?

TRIFONI. Që kur ju erdhi kjo mendje?

VASILIKА (*prerë*). Tani na erdhi. Sepse nesër, edhe një milion të kesh, një tjetër si ajo s'e gjen dot kurrë!

TRIFONI. Demek... për këtë më kërkua? Nëna le të bëjë si të dojë, po, sa për vete, them t'ia falim fshatit. S'kemi nevojë për të.

FILIPI (*me të mirë*). E q'dëm kemi, po ta mbajmë, more Trifon? Se as për para s'kemi nevojë.

TRIFONI (*ngrihet*). S'bëhet ajo që thoni ju. S'është puna te paratë, por, për të mbajtur, s'e mbajmë dot. Këtë them unë.

FILIPI (*ngrihet*). Prit pak, prit.

VASILIKА (*me inat*). Ti, Trifon, mos thuaj se

s'ke nevojë për para. Para ca kohësh sikur na kër-kove borxh.

TRIFONI (*me qetësi*). Është e vërtetë. Shtëpia e re ka ca halle, po gjëra të vogla janë, njeriu rregullohet shpejt.

VASILIKА (*ngrihet*). Lëri ato, Trifon! Thuaj që ke nevojë për para, atë thuaj. Bile... më mirë të pranosh së ke rënë në ujdi me nënën që ta shisni tani, sa më shpejt...

TRIFONI. Eh, ku të shkon mendja! (*Filipit.*) Në-na e di vetë, unë as kam ndërhyrë, as dua të ndërhyj.

FILIPI. Trifon, vëllezër jemi, e s'po merremi vesh. Po të duash ti, nëna nuk ta prish. (*Shpejt.*) Mendohu mirë.... Dy dhoma ti, dy ne... Secili çelësin e tij. Mendohu, Trifon!

TRIFONI (*prerë*). Ja ku po jua them edhe një herë: nuk jam dakord. Dhe nëse nëna do që ta shesë, le ta shesë. Ne s'kemi përsë të përzihemi.

VASILIKА (*me ankth*). Këtu diçka luan...

FILIPI (*inatoset*). Fundja, sa të takon ty për të marrë, t'i jap unë, në vend.

#### Pauzë.

TRIFONI (*fyhet*). Ç'më pandeh ti, njeri të pazar-lleqeve?! Të thashë, as kam nevojë për para, as më takon ndonjë qindarkë. (*Ngre zërin.*) Edhe tri rroga në shtëpi të mos isha, atje ku s'më takon, s'do të vija dorë.

FILIPI.. Parimet i di edhe unë!

TRIFONI. Cilat parime? (*Tund kokën.*) Ç'janë këto, more Filip, ç'janë këto!...

FILIPI (*me emfazë*). Koha dhe njerëzit përbëjnë

një unitet. Dhe çdo përpjekje për ta çarë këtë, është artificiale.

TRIFONI. Ah, po, e shtron filozofikisht? Mirë atëherë. (*Ulet.*) Sipas teje, na qenka e kohës t'i rrëmbesh shoqërisë sa të mundësh më shumë?!

VASILIKA. Kush po rrëmbe? Gjënë tonë po rrëmbejmë?

FILIPI (*ashpër, së shoqes*). Pusho ti! (*Trifonit.*) Filofozi po bën ti, jo unë. Ne s'mund të mohojmë vetveten. Jashtë kësaj çdo teori është bosh.

TRIFONI (*merr zjarr*). C'thua ti, ta bëjmë shtëpi pushimi? Posi! Shtëpia e Shollajve! Tërë vitin brenda katër mureve të zyrës. Duam shtëpi personale, ajër personal, det personal... Përse jo?! Dhe dimrit atje të thyejnë kokën minjtë!

FILIPI. Ou?! S'paskemi të drejtë të pushojmë në shtëpinë tonë. (*Qesh thatë.*) Po kjo mendje kështu?!. . .

TRIFONI (*po me ironi*). Po, po! Në pronën tënde, në kopshtin tënd, nën hijen e pemëve të tua...

FILIPI (*me zemërim*). Mjaft! Të lutem... Po s'jam i tillë unë, more vesh? Joo! (*Shëtit lart e poshtë.*)

*Vasilika rri si engrirë.*

TRIFONI. Kështu fillon e keqja.... (*Ngrihet.*) Mblidhe mendjen, vëlla, që të jesh në unitet me kohën. (*Bën të dalë.*)

FILIPI (*i shkon pas, e mban nga krahu*). Më rëndove, po s'ka gjë. E mira është të mendosh për të gjithë, jo vetëm përvete. Fjala e fundit, ç'thua?

TRIFONI (*çliron krahun*). Më duket se vetëm përvete po mendoni ju! (*Del.*)

Filipi qëndron në vend si i engrirë, pa ditur ç'të thotë.

Vasilika i shkon pranë.

VASILIKА. Janë bërë një me nënën.... (*Me tërbim.*) Nuk dashka t'ia japim ne ato para!...

FILIPI. Nuk e ul hundën ai, jo!

VASILIKА (*qan*). Na iku, na iku!... S'dite t'ia mbushje mendjen! (*Shpérthen.*) Një ditë do të pëlca-së dhe ai për atë shtëpi, po s'do ta gjejë kurrë, kurrë! (*Hyn në dhomë, pérplaset në divan.*) Po ç'do të presësh nga një njeri që s'ka parë botë me sy?

FILIPI (*hyn pas saj, ashpér*). Lëri fyerjet ti, se s'është njeri dokudo ai! S'është nga ata që shtiren, jo. Thotë t'ia falim fshatit dhe e ka me gjithë zemër, se ka kaluar një jetë të tërë atje, po ç'kusur kemi ne që nuk na intereson...

VASILIKА. T'i qepesh prapë! Ai e ka në dorë.

FILIPI. Këtë punë e ka në dorë nëna. Dhe ta mbyllim muhabetin, se vjen vajza. Na u hodh në grykë qëparë, më keq se Trifoni.

VASILIKА (*nervoze*). Po kjo e marrë kështu?! (*Shkon te bufeja.*) Ora dhjetë e gjysmë... Dhe i thashë që të rrinte me të deri në nëntë.

FILIPI (*ndez një cigare*). S'na prish punë ajo, jo... (*I dridhen duart.*) Puna është se... Mos vërtet iu qepëm si shumë vajzës?

VASILIKА. E, në iu qepëm, çfarë? Për të mirën e saj e bëmë.

FILIPI. Po ku dihet, do ta dojë, s'do ta dojë...

VASILIKА. S'ka pse të mos e dojë. (*Pauzë.*) Të gjitha të mirat i ka. (*Psherëtin.*) Thuaj që e mblo-dhëm mendjen, shyqyr!

FILIPI (*mban vesh*). Ja, po vjen.

Të dy mbajnë frymën. Hyn Etleva, mjaft e qetë. Filipi dhe Vasilika drejtohen nga ajo.

ETLEVA. Mirëmbrama!

VASILIKА. Hajde, bijë e mamasë, të të puth.  
(*Fshin lotët.*) Me jetë të lumtur!

FILIPI (*gjoja i gëzuar*). Goxha djalë, ë?

ETLEVA. Me të e këputa. Mbaroi. (*Heq parde-synë.*) Vetëm një xhiro.

FILIPI (*i shtangur*). Pse?

VASILIKА. E paske prishur? Oj, oj... Po, kur paske pasur tjetër mendje, ç'ishte nevoja të tundeshe rrugëve me të?

ETLEVA. Ju s'hiqnit dorë, o atë, o s'ka. S'kisha rrugë tjetër, m'u desh kjo mbrëmje që t'i jepja fund.

FILIPI. Moj vajzë, moj vajzë! Lodra bën me nderin e familjes? Po atëherë, ç'ishin ato: «mirë, do të shëtis, mirë, do të bisedoj»? Ë? (*E mbërthen nga krahу, e shkund.*) Hyseni s'është njeri dokudo që të talllesh ti! Ta kesh për nder të marrësh nipin e tij. Dëgjon? (*E shkund.*) Me atë rreth që ka ai... Dhe vjen e na bën lodra: «e këputa, mbaroi!» Turp të kesh!

ETLEVA. Asnjë turp s'bëra, baba.

FILIPI (*shkon te dritarja, kthehet; Vasilikës*). Pa vete dhe i them Hysenit: po bëjnë shëtitjen e parë! (*Etlevës.*) Pse s'më the ç'bluaje në mendje?

ETLEVA. Si u mbarokan këto punë kështu?!

VASILIKА (*me inat*). Apo mos ke ndër mend ta palosësh me atë gazetarin?

ETLEVA. Po ju kam thënë që s'kam asgjë me të!

VASILIKА. Ai do të ta ketë bërë mendjen çorape, kurse ne të urojmë për fejesën. Pika prindit, thuaj!...

FILIPI. Po nga njihesh me atë gazetar, xhanëm!  
(*Ulet.*)

ETLEVA. Na erdhi një ditë në uzinë. Unë kisha

bërë një artikull. Ju e dini, unë e kam qejf gazetarinë...

FILIPI. Artikuj shkruaj. Po deshe, vazhdo pér gazetari. Po ç'lidhje ka kjo me ç'të pyeta? (*Ulet në kolltuk.*)

VASILIKА. C'punë ke tē shoqërohesh me tē? As i rrethit tonë éshtë e as duam tē dimë pér tē!

ETLEVA (*fyhet*). Mama, unë s'jamë fëmijë. Ju edhe me Agronin... Shumë gjëra s'i kuptoja atëherë, po tani...

FILIPI. Hë? Çfarë?...

ETLEVA (*e vendosur*). Tani po e shikoj se juve pak ju intereson lumturia e fëmijëve tuaj.

FILIPI (*brof në këmbë*). Ashtu?! E çfarë na interesoka neve?

VASILIKА. Dëgjon, more burrë? Edhe shpirtka-zëm po na bën. (*Etlevës.*) E hape punën e Agronit, e ja ku po ta them: martesa s'éshtë romantizëm.

FILIPI (*ia bën me shenjë*). Mos u nxito, se s'éshtë njeri kundër romantizmit. (*Etlevës.*) Veçse, moj çupë, martesa nuk mund tē mbështetet vetëm mbi romantizmin. Familja, që tē krijohet si duhet, kërkon edhe gjëra tē tjera, ndoshta edhe më tē rëndësishme. Romantika, domethënë dashuria, nuk éshtë gjithçka.

ETLEVA. Dhe ajo familje, pa atë, nuk éshtë as-gjë. (*Bën tē dalë.*)

FILIPI. Dëgjo, do tē mendohesh edhe një herë, apo...

ETLEVA. Pér atë? Kurrë! (*Shkon matanë.*)

VASILIKА. Po tani? (*Pauzë.*) C'iu fute fare kësaj valleje!...

FILIPI. As që ma merrte mendja se do t'i vente filli kështu. (*Pauzë.*) C'u vura në pozitë me Hysenin...

(*Me forcë.*) Të nipit mirë ia bëri ajo, goxha djalë e kërkon mblesërira! (*Pauzë.*) Fundja, vajza ka të drejtë e saj të vendosë.

VASILIKА (e pikëlluar). Dhe kur ndodhi tani që Hyseni të ka propozuar për kryetar dege!

FILIPI. Ka dhe të tjerë që vendosin atje. (*Pauzë e shkurtër.*) Edhe në s'u bëfsha kryetar dege, asgjë s'humbas. (*Papritur.*) Fundja, unë nuk jam në funksion të Hysenit!

VASILIKА. Ou?! Po e hedh poshtë tani?

FILIPI (*i afrohet*). Po ç'thua ti, ta marr vajzën për dore e t'i them nipit të Hysenit: urdhëro? S'e do, s'e do. Sa për Hysenin, më mjaftojnë marrëdhëni et zyrtare. Bën studime, e ndihmoj, nesër do të bëj unë, do të më ndihmojë ai. (*Ulet në tavolinë.*) Pa më sill atë dosjen tani, se kam punë. Ti shko të flesh.

Vasilika shkon te rafti në korridor e sjell një dosje.

Të ma dijë për nder Hyseni që lodh trutë e i sistemoj të dhënat për të vdekurit. (*Shkruan.*) Vdekje nga infarkti... (*Kthehet nga Vasilika.*) Vetëm materialet e sërës së dytë mund të përdorësh për të ndezur sobën.

VASILIKА. Dëgjo, Filip...

FILIPI. Hë?

VASILIKА. Po na vijnë humbjet radhë... (*Ur-dheruese.*) T'i thuash nënës, kur të vijë në Tiranë, se çupa ka qenë shëndetligë, nuk bën dot pa klimën e detit...

FILIPI. E, e, se vetëm atje ka det.

VASILIKА. Ah, dhe ti! Me nënën duhet takt, jo llafe.

FILIPI Ta hajë djalli, çkam bërë!

VASILIKА (e trembur). Gabove në shkresë?

FILIPI. Ç'shkresë?! I nisa telegram Agronit në Peshkopi: «Etlevën e fejuam me Abdullanë», i them. (Pauzë.) Nesër që në mëngjes duhet t'i nis tjetrin. Turp éshtë dhe nga ajo e postës.

VASILIKA (*shpejt*). Mos ia nis tjetrin. Kjo do ta shpejtojë ardhjen e nënës.

FILIPI (*tund kokën*). Po, po... Ka rrezik të vijë drejt e këtu.

VASILIKA. S'ka të keqe pa të mirë. Kur të marrë vesh se fejesa s'është bërë, do të gëzohet. Ta shfrytëzosh këtë rast.

Zilja e telefonit. Vasilika shkon e ngërë receptorin. Lë hapur telefonin e kthehet shpejt.

FILIPI (*shkon te telefonin*). Alo. Po, unë jam. (Pauzë.) Po, kështu ndodhi. Sipas saj, mori fund. (Pauzë) Unë? Keq më vjen, po, ç'mund të bëja, e bëra. Po, t'i thuash, mori fund. (Mbyll telefonin, aty.) Mori fund dhe që ç'ke me të! (Kthehet ngadalë në dhomë.)

VASILIKA. Hë?

FILIPI. Pyeti për t'u siguruar. «Ç'bëre ti?», më tha. E ç'do të bëja unë?! (Nervoz.) Bëmë një kafe të fortë. (Ulet, shkruan.) Vdekje nga infarkti...

### Tabloja e tretë

Zyra e Filipit, e mobiluar bukur. Përballë një skedar i madh, pranë tij një raft i mbushur me libra. Në të majtë të dhomës një tavolinë e vogël me kolktukë përreth. Nga dritaret e mëdha derdhet drita e një dielli të qartë nëntori. Filipi, mbështetur pas shpinëzës së karriges, qëndron drejt,

me të dyja duart grusht mbi tavolinë. Përpara tij i dërguari nga rrathi.

I DËRGUARI NGA RRETHI. Si do ta lëmë, shoku Filip?

FILIPI (*tepër i përmbajtur, po i mërzitur*). Jua thashë, shok i dashur, s'kam ç'bëj. Planifikimi është planifikim.

I DËRGUARI NGA RRETHI. Edhe unë po jua them prapë: në rrethin tonë këtë tremujor kemi pasur raste të rënda me patologji të ndërlikuar. Penicilina, tetraciklina, aspirina e barna të tjera të shënuara këtu (*ngre nga tavolina një copë letër e ia tregon*), s'kemi më. Tremujori tjetër është ende larg. Ja që harxhuam jashtë planit, ç'të bënim?

FILIPI. Përse e zgjatni? Rregullohuni me ndonjë rreth tjetër. Merrni nga ai ç'ju duhen e, kur të furnizoheni, ia ktheni. Kjo është rrugëzgjidhja, s'ka tjetër.

I DËRGUARI NGA RRETHI. E përse të mos na i jepni ju? Kur të na furnizoni, i mbanë.

FILIPI (*ngrihet*). Më duket se s'është nevoja të na mësoni ç'të bëjmë. Shteti ka plane, ka rregulla...

I DËRGUARI NGA RRETHI. Po sëmundjet nuk vijnë sipas planeve tuaja, shoku Filip.

FILIPI (*mendohet*). Po ta shikosh çështjen nga njëra anë, keni të drejtë...

I DËRGUARI NGA RRETHI (*shpejt*), Ja pra...

FILIPI. Prit (*Pauzë*.) Porse, po ta shikosh nga ana tjetër, del se ju nuk i përfillni rregullat shtetërore të planifikimit në shpërndarje...

I DËRGUARI NGA RRETHI (*e humbet duri-*

*min).* Për ç'rregulla flisni? Cili rregull është më i madh, sesa shëndeti i popullit?

Pauzë e gjatë.

FILIPI. Natyrisht, shëndeti i popullit mbi të gjitha, po ju mund të sqaroheni më mirë me shefin, me shokun Hysen. Unë kam detyra të tjera këtu, po, me që ai shoku mungon.... Nejse, unë vetë s'mund t'jua jap.

I DËRGUARI NGA RRETHI. Ashtu? Epo mirë.  
(Del.)

Hyn Hyseni, një burrë me trup mesatar, i mbajtur mirë, me kostum e borsalinë. Fill pas tij hyn I dërguari nga rrathi.

I DËRGUARI NGA RRETHI (*shpejt*). Shoku Hy-  
sen, desha të bisedoja pak me ju.

HYSENI (*kthen kokën me përtesë*). Më prisni  
jashtë, ju lutem.

I dërguari nga rrathi del.

I përfundove?

FILIPI (*sheh nga shkresat mbi tavolinë*). Edhe  
pak kam. Më hapën punë ca materiale të dosjes nu-  
mër katër, po, më së fundi, i vura në vijë.

HYSENI (*shëtit*). Të dhënat i kam renditur si-  
pas sistemit «Brokhart», që, për mendimin tim, është  
më i sakti. (*Me emfazë*.) Nuk mund të arrish kurrë  
në përgjithësime të mëdha, pa u nisur nga të dhënat  
sasiore. Është sasia, na mëson dialektika, ajo që do  
të kthehet në cilësi, dhe asgjë tjetër... Duke eviden-

tuar tē dhënat mbi mortalitetin, ne analizojmë shkaket dhe, njëkohësisht, rrugët pér ta ulur atë.

FILIPI. Do tē botohet në këtë numër?

HYSENI. Po, më dhanë fjalën. (*Pauzë.*) Këtë radhë mund ta vë emrin tënd si bashkautor.

FILIPI. Jo, s'ka nevojë. (*Sheh letrën që i dërguari nga rrëthi ka lënë mbi tavolinë.*) Ai personi që hyrtani, kërkon tërheqje barnash suplementare pér rrethin. Ünë ia refuzova kërkesën.

HYSENI. Tërheqje barnash jashtë planit? Pse?

FILIPI. Tha se kanë pasur shumë raste me patologji tē ndërlikuar.

HYSENI. Qartë. Mirë bëre! Shteti ka rregulla. (*Ndërron ton.*) Kështu, apo ta përfundosh (*shënon nga materiali që Filipi ka përpala*), ma sill menjëherë t'i hedh një sy, se duhet çuar që sot në redaksi. (*Del.*)

Pas pak hyn me nxitim Nëpunësi.

NËPUNËSI. Ishte këtu shoku Hysen?

FILIPI (*ngre kokën*). Sapo doli. Kush e kërkon?

NËPUNËSI. Ai gazetari që erdhi edhe dje. (*Bën tē dalë.*)

FILIPI. Prit pak, prit! (*Shtyn dosjet.*) Ç'kërkon, xhanëm?

NËPUNËSI (*sheh nga dera*). Ja ku qenka. (*Del te dera.*) E takoi. (*Hyn në dhomë, ulet.*) Eh, ç'kërkon! Do material gazeta. Me ç'mora vesh, do tē kontrollojë gjithë dokumentacionin e degës sonë. Me një fjalë, kërkon tē njoftohet hollësisht pér marrëdhëni tona me bazën, mos kemi zvaritje tē kërkesave tē saj, shkëputja nga ajo e më the tē thashë.

FILIPI. Shkëputje nga baza? Ndonjë fërkim

edhe mund të kemi pasur me bazën, po këto janë në natyrën e punës, s'u shmangesh dot.

NËPUNËSI. Shoku Hysen është i tmerrshëm për t'i argumentuar gjërat. S'ma merr mendja se do të nxjerrë gjë ai gazetari.

FILIPI. Nga njëra anë, ashtu është, po, nga ana tjetër, ama, ndonjë të metë dhe mund ta kemi. Të përsosur s'mund ta quajmë veten. Shoku Hysen di të drejtojë, kjo është kryesorja.

NËPUNËSI (*duke u çuar*). Ama, njerëzit këtu kanë filluar të flasin. Thonë se në degën tonë paska shumë gjëra që nuk shkojnë. Dhe, me ç'mora vesh, ky gazetari, bashkë me ata që kanë hapur gojën, kërkon të gjejë rrënjen, burimin... Prite kur të na vijë dhe ndonjë kontroll punëtor. Se ku qenka kjo rrënje, ec e merre vesh, po deshe... Të ma lëjë mua shoku Hysen atë gazetarin, ia rregulloj qejfin mirë...

FILIPI. Dëgjo, Islam, unë s'mund të marr dot pjesë në bisedë, se jam duke përfunduar një studim, po, të lutem, me të mbaruar, ec e më njofto.

NËPUNËSI. Do të vij menjëherë. (*Del.*)

FILIPI (*me vete*). Si fryhet edhe ky! Ka qenë mjeku më i dobët që kam njojur dhe as sot e kësaj dite s'e kam marrë vesh ç'djallin pati Hyseni që e solli këtu...

Nga korridori vjen zhurmë.

Me sa duket, mbaruan.

Hyn Petriti.

Hë, Petrit, ç'kemi?

Heshtje e gjatë.

(*E vështron i habitur.*) Ç'është?

PETRITI. Filip, a mund të këmbejmë nja dy fjalë?

FILIPI (*edhe më i habitur*). Po fol, more Petrit, po të dëgjoj.

PETRITI. Pse ia kishe refuzuar kërkesën për barna atij të rrëthit?

FILIPI. Ou?! Te ti erdhi ai?

PETRITI. S'kishte pse të vinte tek unë, po u ndodha në zyrën e Hysenit dhe e mora vesh. Hyseni, natyrisht, e miratoi veprimin tënd dhe... e përcollti duarthatë. Po mua s'më shqetëson aq veprimi i Hysenit, Filip. (*I afrohet.*) Unë e kam hallin të ti.

FILIPI. Ç'ka këtu për t'u shqetësuar? Ose ta zëmë se paska diçka, pse të shqetëson vetëm veprimi im dhe i Hysenit jo?

PETRITI (*e sheh në sy*). Do të flas edhe për Hysenin. Tani dua të di: pse ia refuzove?

FILIPI. Petrit... (*Tund kokën.*) Unë s'të kam ndërhyrë ndonjëherë në punët e tua të zyrës.

Hyn Nëpunësi.

NËPUNËSI. (*Filipit*). Të kërkon shoku Hysen.

FILIPI. Ja, mbarova.

Nëpunësi del.

PETRITI. Po të kesh vënë re në punën time veprime që nuk shkojnë dhe s'më ke thënë, gabim ke bërë. (*E sheh në sy.*) Ne jemi komunistë, Filip, dhe ndaj njëri-tjetrit s'duhet të mbajmë rezerva. (*Pauzë*

*e gjatë.)* Filip, do të të flas hapur. (*Shëtit nëpër dhomë.*) Para se të vija këtu, u gëzova që do të punoja me një shok të vjetër. Sa net kemi gdhirë bashkë mbi libra... C'ëndrra thurnim atëherë për të ardhmen... Ëndërronim të bëheshim mjekë të zotë, t'i shërbenim popullit... Për vete s'di ç'të them, po ti vërtet u bëre mjek i zotit. Gjithë zonën bregdetare e brodhe. Unë i ndiqja me gëzim botimet e tua mbi sëmundjet infektive, mbi malarjen. Dhe malarja u zhduk te ne, dhe kjo s'është gjë e vogël. (*Pauzë.*) Pastaj ti erdhe në ministri. Unë u gëzova, ndihma jote këtu do të ishte e paçmueshme. Prisja të botoje studime të tjera, po, për çudi, ato filluan të rralloheshin, derisa u zhdukën. Ke vite që s'boton më asgjë... Lidhjet me klinikën i ke humbur... Të them të drejtën, kjo rënie kështu...

FILIPI. Petrit, unë s'jam bërë për të qarë hallin. Nga njëra anë, sa munda, dhashë, nga ana tjetër, s'është e thënë që gjithë sa fillojnë, do të përfundojnë në shkencëtarë.

PETRITI (*me vendosmëri*). Të paaftët po, po jo të aftët! S'e ke pyetur veten gjatë këtyre viteve, se nga vjen kjo tërheqje? (*Me hidhërim.*) Mbaj mend si sot, në fakultet ti mbaje një xhaketë shumë të vjetër. Ishe i martuar, kishe halle, vetëm unë e dija që ajo xhaketë ishte e babait... E megjithatë ti ishe i shkëlqyer në mësime. Ndërsa sot... Eh, Filip, Filip!

FILIPI (*ngrihet, nervoz*). Sikur s'është nevoja për kaq mallëngjim! Nevojat e shtetit janë të shumta. Po këto punë këtu kush do t'i bëjë, a nuk duhen edhe këtu specialistë?

PETRITI. Po.

FILIPI. Atëherë?

## Hyn Nëpunësi

NËPUNËSI. Shoku Hysen më tha të shkosh tani.  
FILIPI. Të thashë që jam i zënë!

Nëpunësi mbledh supet i habitur e del.

PETRITI. Mendimi im është që mjeku, edhe pse mund të punojë në zyrë, nuk duhet të shkëputet nga klinika. Ja, të marrim Hysenin. Ai ka mbaruar një universitet me tradita në mjeksi. Dikur mua vetë më ka ndihmuar mjaft në zgjidhjen e problemeve, atje, në bazë. Po tani, për fat të keq, po shoh se është shkëputur fare nga klinika, e ka mbërthyer rutina, ndryshku. Dhe, se ku e ka burimin kjo, të them të drejtën, nuk po e marr vesh.

FILIPI. I dashur Petrit, Hysenit, si ti, si unë, duhet t'i heqim kapelën për eksperiencën, për kulturën, për aftësitë. Katër-pesë gjuhë të huaja i di, jashtë shtetit ka shkuar vazhdimi. Dhe një farë eksperience nga përvoja botërore e ka sjellë këtu.

PETRITI. Të mos i ngatërrojmë gjérat, Filip! Ne vërtet kemi marrë nga përvoja e përparuar botërore, po parimet e organizimit tonë s'i kemi cënuar kurrë! Dhe cili është parimi bazë i mjeksisë sonë? T'i shërbëjム popullit! Po atëherë, si është e mundur që edhe në një rast fare të veçantë të lëmë një krahinë pa barna? Ç'eksperiencë është kjo, eksperiencia jonë, apo ajo që ka sjellë Hyseni?

FILIPI. Të mësohen ata të rretheve të kursejnë, të mbajnë dorën.

PETRITI. Në qoftë se i kanë shpërdoruar, kritikoi, merr masa, po njerëzit pa barna s'mund t'i lësh. Ky s'është kursim, Filip, jo... (Pauzë e gjatë.) Botën

e vjetër e zhdukëm, po mikrobet e saj, po i lamë shtigjet hapur, mund të vërshojnë drejt nesh në çdo kohë, Filip, në çdo kohë...

Hyn nëpunësi me nxitim.

NËPUNËSI (*Filipit*). Shoku Hysen të urdhëron të shkosh tani, urgjent.

FILIPI (*i bërtet*). E mora vesh! I thuaj se po vij. (*Ngrihet*.)

Nëpunësi del.

Jo, Petrit. Ajo kohë vdiq njëherë e përgjithmonë.

PETRITI. Shko, Filip, shko? Bluaje mirë eksperiencën e përparuar të shokut Hysen.

FILIPI (*shtanget*). Petrit, prapë... (*Merr dosjen*.) Dhe, nëse kemi disa të meta, s'do të thotë se duhet të dëshpërohem... (*Bën të dalë*.)

PETRITI (*duke dalë*). Filip, do të bëje mirë t'ia dërgoje pa vonesë barnat atij rrathi.

FILIPI (*pak nervoz*). Do ta bisedoj dhe një herë me Hysenin. Sa për ato të tjerat që the, se na ka zë-në ndryshku e ku di unë, i dramatizon kot gjérat, Petrit. S'është ashtu, jo! (*Dalin*.)

## A K T I I D Y T È

### Tabloja e katërt

Dhomë e apartamentit të Filipit. Vasilika është duke hekurosur. Nora i bie violinës, po shpejt e lë e shkon matanë. Hyn Etleva, pas saj Petriti. Etleva shkon te dera e dhomës, Petriti qëndron në korridor.

ETLEVA. Mama, Agroni na shkruan se i duhen ca libra. (*I tregon një pusullë.*)

PETRITI (Vasilikës që del në korridor). Meqë tani nisem për në Peshkopi, mund t'ia çoj unë.

VASILIKË (e thartuar). Ç'janë këto libra? Ai i mori të gjitha librat e tij.

ETLEVA. Po i duhen edhe këto. (*Pauzë.*) Të shoh, a janë në raft.

VASILIKË. Në raft qenkan? (*Prerë*) Prit, prit! (*Petritit.*) Janë shumë?

PETRITI. Nja shtatë copë. Ka në dorë një studim dhe...

ETLEVA (*Petritit*). Librat më me rëndësi babai i mban këtu. (*Tregon raftin e madh.*) Sikur të shikojmë bashkë?

PETRITI. Pse jo?

Etleva dhe Petriti shikojnë me radhë katet e raftit. Vasilika qëndron pak mënjanë.

Ja ku janë. (*Shënon me dorë.*) Pesë vëllime. (*Shikon përsëri.*) Edhe këta të dy këtu. (*Shënon në një vend tjetër.*)

ETLEVA. Terapia e... Ç'lexon kjo kështu? (*Qesh, provon kanatin, po ai është i mbyllur.*) Mama, e ke çelësin?

VASILIKA (*prerë*). Librat mund t'i humbasin andej. S'janë romane, janë plaçkë me vlerë.

PETRITI. Agroni më shumë merak ka librat, se rrobat që vesh.

ETLEVA (*si me vete*). Më duket se çelësi është në sirtarin e bufesë. (*Niset.*)

VASILIKА (*e ndalon*). Prit, ku shkon? Librat janë të babait, s'janë as të miat, as të tuat, as të Agro-nit. Të vijë ai njëherë.

PETRITI. Po halli se s'kam kohë... Sot kam qenë tërë ditën në spital dhe s'e takova dot Filipin.

ETLEVA. S'thotë gjë babai, jo.

VASILIKА (*i afrohet raftit*). E cilat do ai?

PETRITI (*ia tregon*). Këto këtu dhe ato atje.

VASILIKА (*vë duart mbi xham, mat hapësirën*). E shikon ti çupë? Kaq mbetet bosh. Të na nxijë vendi bosh si vrima e dhëmbit të shkulur? Jo, jo, nuk mund ta shëmtojmë dollapin ne.

ETLEVA (*i vjen rëndë*). Mama, po aty vëmë të tjera.

VASILIKА. Atë e di unë... S'kemi të tjera kështu të trasha dhe me këto ngjyra.

PETRITI (*ngadalë*). Epo, atëherë...

ETLEVA (*shpejt*). Prisni fare pak, ju lutem. (*Vasilikës, që i afrohet fare pranë.*) Mama, është turp... Me gjithë mend e ke?

VASILIKА (*bën të hyjë në dhomë*). Edhe po të dua unë, s'kam ç'bëj. Çelësin e mban yt atë.

ETLEVA (*Petritit*). Një minutë. (*Hyn në dhomë, kërkon në një sirtar të bufesë po s'gjen gjë, del në korridor; Petritit.*)  
Nuk po gjejmë dot çelësin.

Dëgjohet boria e makinës.

PETRITI. Po iki, atëherë.

ETLEVA (*i afrohet*). Do t'i them babait t'ia nisë menjëherë.

PETRITI. Ashtu bëj. Titujt i ke të shënuar aty. (*Bën nga dera, ndalet.*) Po s'harrove, thuaj Filipit, të lutem, ç'bëri për atë laboratorin e Sukajt. Sa t'ia kujtosh, se e di vetë ai. Mirupafshim! (*I jep dorën.*)

Vasilika del në korridor.

(*Vasilikës.*) Ditën e mirë!

VASILIKА. Udha e mbarë!

ETLEVA (*shkon pas Petritit*). Agronit bëjini shumë, shumë të fala.

Petri del. Vasilika hyn në dhomë. Etleva qëndron në korridor, vështron për pak çaste raftin, i hedh një sy letrës me titujt e librave dhe hyn në një nga dhomat. Pas pak hyn Filipi, në dorë mban një katalog që e lë mbi raft. Etleva del në korridor, në duar mban një letër vizatimi teknik dhe kutinë e veglave.

ETLEVA. U vonove, baba. (*I merr pardesynë, e var.*) Bie shi?

FILIPI (*merr katalogun, e fshin*). Pak. (*Pauzë.*) C'më qenka lagur!

ETLEVA (*i afrohet*). Ç'është ai? Libër?

FILIPI. Katalog mobiljesh. Ka një model të bukur biblioteke. (*Duke e hapur, hyn në dhomë; Vasilikës.*) Ja ku e ke.

VASILIKÀ (e gëzuar). E solle? (E sheh.) Qenka vërtet i mirë.

ETLEVA (e sheh). Ne shumë të mirë e kemi bibliotekën.

VASILIKÀ (Filipit). T'i bëjmë një ndryshim këtu (*shënon me gisht*), që të mos na dalë pikë për pikë si ajo e Hysenit.

FILIPI. Kur ta porosisim, shohim e bëjmë. (Ulet.)

ETLEVA. S'lamë gjë pa bërë si Hyseni! (*Shkon në korridor, merr nga rafti letrën me titujt e librave.*)

VASILIKÀ (Etlevës). Ka parë botë ai, vajzë...

ETLEVA. Posi, posi... (*Filipit.*) Baba, Agroni na shkruan se i duhen ca libra. (*I zgjat letrën.*) Ja, këto. Tani ishte Petriti, po s'kishte kohë të priste, se u nis menjëherë për në Peshkopi. Ne s'kishim as çelësin...

VASILIKÀ (Filipit). Çelësin e kisha, po nuk ua dhashë. (*Shkon te bufeja, e nxjerr.*) Ja.

ETLEVA (habitët). Ashtu?!

Heshtje

FILIPI (Etlevës). Mirë bëri. Të donte të merrej me shkencë Agroni, kishte qëndruar këtu. Atje për t'iu mburrur shokëve i do.

ETLEVA. Agroni s'është nga ata njerëz, baba...

FILIPI (rreptë). Mjaft tani!

ETLEVA. Jo! Po t'i studioje vetë, ndryshonte puna, po ti ke kaq kohë që s'i ke hapur ato...

Pauzë e shkurtër.

VASILICA. Moj, po nuk e di yt atë ç'punë duhet të bëjë?...

ETLEVA. Baba, ti vetë na ke mësuar ta urrejmë meskinititin, shpirtvogëlsinë... .

FILIPI (*ngrihet, shëtit i nervozuar.*) A, unë qen-kam... ne qenkemi... (*Kthehet nga ajo.*) Në dy gjë-ra dallohet njeriu sa kulturë ka: e para, sa i respek-ton prindërit, e dyta, sa e respekton dinjitetin famil-jar. (*Ecën lart e poshtë.*)

ETLEVA. Dikur, edhe kur vije te gjyshja, në fshat, librat me vete i sillje, studjoje.

FILIPI (*si vajtueshëm*). Kur të humbasë dritën e syve merre për dore babanë tënd... Po jo kështu, jo... Dinjiteti familjar mbi të gjitha!

ETLEVA. Dinjiteti familjar? Mos tregon respekt për dinjitetin familjar sjellja juaj me Agronin? Kaq kohë që i mbani inat, e pse? Sepse, sipas jush, bëri dy gabime të pafalshme: u martua me shoqen e kla-sës, që e njihte qysh prej pesë vjetësh dhe... .

FILIPI (*e ndërpret*). Ç'i duhej ajo martesë, pa mbaruar mirë shkollën? Të rregullohej njëherë për vete, të stabilizohej... .

ETLEVA. Dhe i dyti: nuk pranoi që të ndërhynte Hyseni për t'i ndryshuar emërimin nga Peshkopia në Tiranë... .

FILIPI. Dhe ç'thua ti, mirë bëri?

ETLEVA. Derisa gjithë kursi kishte dhënë fja-lën se do të shkonin ku kishte nevojë atdheu, si do të veçohej nga shokët?

FILIPI (*shpërthen*). Mjaft! Po bëhem copë për ju! Jua siguruam gjithë të mirat dhe si shpërblim për këtë kërkojmë nga ju vetëm mirënjohjen. Po as këtë s'po na e jepni. (*I afrohet.*) Mos për egoizmin tonë s'e deshëm atë martesë të Agronit? Mos për

egoizmin tim i dhashë, me ndihmën e miqve e të shokëve, specialitetin më të mirë që mund të gjetet? Nga ç'motive u nisëm ne pér fejesën tënde? I pashëm, i zgjuar, me rreth familjar... (*Ngre zërin.*) A. mundesh ti vajzë, t'i lësh parimet mënjanë e ta shikosh jetën ndryshe?

ETLEVA (*me dhembje.*) Baba, jo!... Nuk ke të drejtë...

Pauzë.

VASILIKA. More, po që kur ka shkuar në uzinë, kjo...

FILIPI. S'paskam të drejtë, ë?... (*Me forcë.*) Mos po bëhemë egoistë që mendojmë pér shtëpinë tonë, pér kullën e Bregut?... Që është bërë me djer-sën e ballit?... Që yt gjysh e jot gjyshe kanë hequr kafshatën e gojës pér të?... Që i kanë mbajtur mbi shpatullat e tyre gurët... dhe jo pér vete, po pér ne, pér mua, pér tét vëlla, pér ty?

ETLEVA (*me bindje.*) E pérse ta duam? Kohët tani ndryshuan. Kur e bënë, ata nuk mund ta dinin se një ditë ajo shtëpi do të ishte diçka krejt e tepërt pér ne.

VASILIKA (*me gjithë zërin.*) Po është jona! Jona!

ETLEVA. Shtëpia jonë është kjo ku banojmë.

VASILIKA. (*si me të qarë.*) Etlevë, moj bijë... Dëgjo, t'u bëftë mamaja... T'u lutëm mbrëmë... pér ty... pér të ardhmen tënde... Ne do të vdesim një ditë... Ju do ta gëzoni atë...

ETLEVA. Ah, mama! Po të vareshin gëzimet tona nga kjo...

FILIPI (*me rrëmbim.*) Tani që je e re, shkon në

aksione, në zbole, bën jetë shoqërore, dhe mirë bën, po nesër... kur të krijosh familje...

VASILICA (*me lutje*). Meqë e hapëm këtë, vetëm një gjë të kërkojmë: të paktën, mos na kundërshto para gjyshes.

ETLEVA. Para gjyshes!... E fyjet gjyshen e gjorë, sepse i doli krah Agronit dhe tani...

FILIPI (*e ndërpret, me zjarr*). Futu pak në shpirtin tonë, Etlevë! Nuk jemi egoistë... Ti kujton se është ana materiale ajo që na shtyn, por gabon. Ka edhe arsyem më të thella te njerëzit! Kam kaluar fëmijninë në atë shtëpi, kam kaluar rininë.... Më dhemb çdo gur e çdo skutë... Kur shkoj atje, më duket sikur vetëm gjuha u mungon të më flasin. E këto janë lidhje shpirtërore; para këtyre çdo lidhje materiale e humbet kuptimin e prandaj... dhe meritojnë më tepër respekt. Ti duhet ta kuptosh vetë këtë...

ETLEVA (*me zë të lartë*). Si mund ta kuptoj këtë, baba! Ajo shtëpi, në këtë rast, është vilë. Ai tjetri...

FILIPI. Vilë?!

VASILICA. Po na bën edhe borgjezë? (*shfryn*) Shtëpi, vilë, quaje ç'të duash, plaçka jonë është.

FILIPI (*Vasilikës*). Prit! (*Etlevës*) Si the? Vilë? Pa thuaje dhe një herë!

ETLEVA. E thashë...

VASILICA. Dërrmoi prindërit e tu, dërmoi!...

FILIPI (*ulet si i këputur*). Mirë, mirë... Bukur... E qartë. Drejt na kuptove. Posi! Drejt, shumë drejt. Të lumtë, bijë e babait.

VASILICA (*shpejt, me ankth*). Po si s'e kuption, moj, se xhaxhai yt, Trifoni, ia ka hedhur grepat...

FILIPI (*ashpër; Vasilikës*). Mjaft! Lëre tanë!

Mjaft! (Butë; Etlevës.) Shko, vajzë, shko! E qartë!  
(Zë kokën me duar.)

ETLEVA. Baba...

VASILIKА (e trembur). Mirë, mjaft. Shko tani.

ETLEVA. Përse? Prisni, ju...

VASILIKА (e shtyn). Moj po ik tani!

ETLEVA (thërret). Po më lini të flas!

FILIPI. Ah! S'ke mbaruar? Paske edhe të tjera?

ETLEVA. Ju... (E tronditür.) Si s'e kuptoni që,  
sa vjen, po ngushtoheni e po ngushtoheni?... (Del  
nga dhoma me rrëmbim.)

FILIPI. Si the? Si the? Pa prit, prit!... (Ngrihet,  
mendohet pak, ulet prapë.)

Heshtje.

VASILIKА. Merresh kot me të. Hap sytë me  
nënën, më mirë...

FILIPI. Shko edhe ti. Të lutem, Vasilikë, shko!

### Tabloja e pestë

Dhoma e apartamentit të Filipit.

Po ajo ditë, buzëmbrëmje. Vasilika vete e vjen nëpër shtëpi;  
duket shumë e zënë me punë. Hyn Nora, në dorë mban një  
rrjetë me ushqime.

VASILIKА. E more verën?

NORA. Po. Katër shishe. (Lë rrjetën mënjanë.)

VASILIKА. Tani shko shpejt të çosh mishin në  
furre.

NORA (ulet në minder). Dale pak. U lodha.

VASILIKА (me të mirë). T'u bëftë mama ja, tani.

Sonte kemi gjyshen mysafire. Ta presim si s'ka më mirë. Që kur vdiq gjyshi, ajo është shumë e mërzi-tur, s'e ke parë? Duhet t'i krijojmë ambient, ngroh-tësi. Ta shikojë me sy se si e presim ne e si e pret. xhaxhi Trifoni. Shko, tu bëfsha!

NORA (*me të madhe*). Jo, jo!

VASILIKА (*menjëherë*). Sht! Gjyshja po fle.

NORA (*ngrihet, merr violinën*). Pesë minuta. Sa- t'i bie një pjese popullore. (*Luan.*)

VASILIKА (*e përbajtur*). Ç'bën, moj?

NORA (*pushon pak*). Për inat të saj. Mbrëmë te xhaxhi Trifoni më tha se muzikën popullore e luaj shumë keq (*Luan.*)

Vasilika shkon i rrëmbejn harkun nga dora.

VASILIKА. Ta theva në kokë!

NORA: Kujt ia rrëmbejn ashtu? (*Qan.*) Pse, ç'jam unë? (*Përplaset në divan.*)

VASILIKА (*shkon tek ajo, ia zgjat harkun; me të butë*). Na, merre! Fundja mjaft fjeti nëna. Merre!

NORA (*ngre kokën, e shtyn me dorë*). Nuk dua.

Hyn Dhoqina, një plakë e gjatë, trupdrejtë, e fortë. Qëndron te dera pa lëvizur nga vendi.

VASILIKА (*i del përpara, gjithë mirësjellje*). Urdhëro, nënë, ulu! (*I tregon kolltukun.*)

Dhoqina shikon rrotull, përsëri pa lëvizur nga vendi. Lëshon një shtëllungë tym duhani e me hapa të ngadaltë shkon te dritarja, sheh në rrugë. Pastaj vështron perdet nga lart poshtë.

DHOQINA. Ç'i keni këto perde si rrogoza? Nuk ju zihet fryma?

VASILIKА (i vjen inat, po s'e bën veten). Kështu i mbajnë tani. Fjete mirë?

DHOQINA. S'i mbajnë të gjithë kështu. (Shikon Vasilikën që rregullon mishin në tavë.) Ç'e keni gjithë atë mish? Keni mysafirë? (Ulet në kolltuk.)

VASILIKА. Pse, moj nënë, vetëm për mysafirë bëjnë njerëzit mish?

DHOQINA. Po ndaje përgjysmë, moj nuse! Ç'janë këto shpenzime?

VASILIKА. (me mburrje). Filipi, moj nënë, bën studime shkencore mbasditeve dhe merr ndonjë lek...

DHOQINA. Ou! (Pauzë.) Po rrrogë nuk merr Filipi?

VASILIKА. Si s'merr, moj nënë! Po ato janë jashtë orarit, studime.

DHOQINA. E mora vesh. Edhe në fshat punohet mbasdite, po s'kanë nga këto gjëra, de.

Heshtje.

(Vë re Norën që rri turivarur.) Po kjo çupë, ç'ka kështu?

VASILIKА. I dhemb pak koka. (Norës.) Hajde, t'u bëftë mamaja.

DHOQINA. Prandaj i binte qemanes?

NORA (ngrihet me naze). Më jep edhe njëzet lekë për akullore.

VASILIKА. Ik tani, nesër.

NORA (lë tavën). Jo, i dua sot.

DHOQINA (rrëptë). Tundu vendit tani!

Nora lë tavën e bëhet gati të dalë.

VASILICA (*shpejt*). Prit! Hajde, na. (*I nxjerr nga sirtari, ia jep.*)

DHOQINA. S'ka faj ajo. Ia keni zgjatur bishtin.

NORA. S'kam bisht unë. (*Merr tavën, del.*)

VASILICA. S'janë si fëmijët e dikurshëm këta sot, moj nënë.

DHOQINA. Posi, posi. Kur nuk janë dhe disa prindër si ata të dikurshmit...

Hyn Etleva. Shkon me vrap te gjyshja, i ulet mbi anën e kolktukut, e përqafon.

ETLEVA. Biletat i mora. Tri copë.

DHOQINA. Çfarë theatro do shohim?

ETLEVA. Është një dramë nga lufta me gjermanët. Bëhu gati tani, se në gjashtë fillon.

DHOQINA (*nxjerr sahatin e xhepit*). Kemi kohë.

VASILICA (*Etlevës*). Telefonoi Trifonit të na vijë për darkë me Lenën. (*I bën shenjë, e heq mënjanë.*) Thuaja me marifet, që vetëm ata të dy të vijnë.

ETLEVA (*mënjanë, me zë të ulët, po shkoqur*). C'është kjo, mama? Gjithmonë kështu: të vijnë këta, po ata... Edhe pardje kështu e bëre, më erdhën shqet e shokët e uzinës, kurse ti the: s'pate edhe të tjerë për të ftuar? (*E vendosur*.) S'ta thashë atë ditë, po ti edhe sonte...

VASILICA (*nxehet, po me zë të ulët*). S'të ka rënë shtëpia mbi krye, prandaj më flet kështu.

Etleva diç do t'i thotë, po Vasilika largohet me qëllim.

Etleva del në korridor.

DHOQINA. Zor se vjen Trifoni. Kanë mbledhje

atje në punë, do të rrinë vonë. Bëjnë luftë me burokracinë. M'i shpjegoi të tëra, një më një.

Etleva në korridor, telefonon.

VASILIKA (*Etlevës, me zë të lartë*). Thuaju se deri në dhjetë i presim.

DHOQINA (*ngrihet*). Edhe atje, në fshat, lëvritje të madhe ka. Kanë ndërruar dy kryetarë që kur iku Trifoni. Ai që erdhi në këmbë të Trifonit, s'ishte i punës. Populli u ngrit kontra, nuk e duam që nuk e duam. Dhe e hoqën. Ky tjetri është burrë me mendjen katërqind dërhem. I pushkës dhe i parmendës. Ka qenë shok me djalin, me Markun. Di t'i qëndrojë punës mbi krye dhe gjithë ditën trapit, vu andej e vu këtej. Pa e ka bërë rininë... Puna punë, e kënga këngë...

VASILIKA. Na llafosën kur qemë atje, na llafosën.

Hyn Etleva.

ETLEVA (*s'ëmës*). I thashë. (*Dhoqinës*.) Gati gjyshe?

DHOQINA. Edhe shfaqje bëjnë. Njëherë më vunë edhe mua atje tok me ca plaka të tjera. Na vunë të këndonim. Erdhi edhe Maria, po ku Maria e ku kënga. Një herë, dy, s'erdhë më.

ETLEVA (*qesh*). Dole në skenë, gjyshe?

DHOQINA (*zgjat zërin*). Posi.

ETLEVA (*sheh orën*). Pak shpejt, gjyshe.

DHOQINA (*bëhet gati të shkojë matanë*) Ja. Pa më dërguan fletë nderi. (*Shkon te dera, qëndron*.)

Edhe theatro bëjnë. Theatron e kemi të lashtë andej. Kur jeshë vajzë e vogël, mbaj mend se për të kremte bëheshin shfaqje te sheshi i fshatit. Rräfenin për ndodhira të lashta. (*Etlevës që shpreh padurim.*) Ja, u vesha. (*Del në korridor e hyn në një dhomë.*)

ETLEVA. Po të pres poshtë. (*Vasilikës.*) Lena më tha që, po të mbarojë xhaxhi Trifoni shpejt, do të vijnë. Dhe mos të të zëjë meraku, mama, se teta Lena, edhe ti t'i thoshe, asnje fëmijë s'do të merrte. (*Del me të shpejtë.*)

Vasilika diç do t'i thotë, po s'gjen fjalën.

### Tabloja e gjashtë

Dhomë e apartamentit të Filipit.

Nga njëra prej dhomave del Filipi me disa dosje në duar dhe ulet në tavolinë. Vasilika rregullon disa sende zbukurimi nëpër mure.

Nga dhoma tjetër vijnë tinguj violine.

VASILIKÀ (*lë punën, që aty*). Po mirë, si të është sjellë këto ditë?

FILIPI. Tepër zyrtarisht. Më kërkon vetëm pas-qyrat e vdekjeve dhe materialet e zyrës, asgjë më tepër. (*Me një farë zemërimi.*) Fundja, dhe unë s'bëhem shumë merak. E përsë?

VASILIKÀ (*i afrohet*). Po ty nuk të bie hunda, po të përpinqesh t'i zbusësh sadopak marrëdhëniet. Me atë shoqëri që keni pasur...

Tingujt e violinës vijnë më të fortë.

FILIFI. Vasilikë, thuaj asaj vajze ta ulë një çikë, se na plasi.

VASILIKA. Ç'ke me të? Bën mësimet. (*Vazhdon mendimin e mëparshëm*.) Po kështu, si të thashë.

FILIFI. Ç'thuai ti, t'i bëhem urë? Më ndihmoi për specializimin e djalit, po s'kam pse t'i rri borxhli gjithë jetës. Në djall të vejë me gjithë atë kapardisje!

VASILIKA. (*e trembur*). Filip... Jeni zënë gjë-kafshë?

FILIFI. Nuk jemi zënë, po më duket se po e tepron...

VASILIKA. Po e tepron?! Po si?

FILIFI. Ka ndryshuar fare, ja kështu. As muhabet, as shaka, siç e kanë njerëzit. Dhe e gjithë kjo fill pas asaj që ndodhi...

VASILIKA (*shpejt*). Po dihet ajo! Ta zuri jot bijë bishtin me qerre ty.

FILIFI (*bën të shkruajë*). Mirë, mjaft tanë.

VASILIKA (*po me atë ton*). S'ke pse zihesh me të. S'është Trifoni ai.

FILIFI (*ngre kokën; i përbajtur*). Ç'do të thotë kjo: «s'është Trifoni ai»?

VASILIKA. Se nga Trifoni s'të gjen ndonjë e keq e madhe. Shumë-shumë mund të zhvasë paratë e shtëpisë, po u shit, kurse Hyseni të degdis nga s'ta pret mendja.

FILIFI (*çohet me vrull*). Tani po e tepron ti më keq se Hyseni! (*Ultas*.) Të lutem shumë, mbaje gojn! Pse Hyseni e paska në dorë të bëjë si të dojë? Dhe Trifonin lëre të qetë... Se është njeri me zemër dhe, në do ta dish, s'e arrijmë as unë, as ti. I qëndroi babait te koka tre vjet me radhë, ndërsa unë shkoja

si turist atje. Gjithë ato shpenzime hoqi dhe gjysmë leku s'kërkoi...

VASILIKА. Domosdo, ai e kishte në shtëpi, s'e kishim ne...

FILIPI. Posi, pos! Po që shkoi në palcën e dimrit në Peshkopi dhe ndihmoi djalin tonë të hapte shtëpi, ç'interes pati? I bleu pajisje për kuzhinën, sobë e më the të thashë, kurse i ati dhe e ëma i kthyen krahët...

VASILIKА (*prerë*). Pa interes asgjë nuk bëhet.

Pauzë e gjatë.

FILIPI (*i afrohet*). Po ti harron se njeriu ka dhe zemër?

VASILIKА. Dhe secilit zemra për vete i rreh, ta dish nga unë këtë.

FILIPI (*zgjat zërin*). A? Po yt atë ç'interes pati që për pak sa nuk e shiti edhe atë dyqan të vogël për ty? Me djersën e tij e mbante atë dyqan, po për ty desh i vuri flakën.

VASILIKА (*e humb për një çast*). I erdhi keq se te ti... as kripë nuk do të gjeja në shtëpi.

FILIPI. Pati zemër, Vasilikë, pati zemër, se, me-gjithëqë isha i këputur, të dha buzëqeshur tek unë... Se respektoi dashurinë tënde.

VASILIKА (*pas një hutimi të lehtë*). Po derisa desha unë... (*Shpejt.*) T'i lëmë këto tani se na vijnë njerëzit. Dhe shiko, pas darkës t'i thuash nënës se Trifoni...

FILIPI (*ashpër*). Po mjaft, moj, me Trifonin!

Vasilika hesht. Hyn Nora.

NORA. Ti, babi... ke filluar t'i bërtasësh masë.

FILIPI. Pa ik prej këtu e merru me qemanen tënde!

Nora shkon matanë, pas saj Filipi. Vasilika rregullon tavolinën. Bie zilja e derës. Vasilika shkon dhe e kap. Hyn një grua me pamje të shqetësuar.

GRUAJA. Mirëmbrëma!

VASILIKA. Mirëmbrëma, Lumturi! Ç'ke kështu?

GRUAJA. Uh, moj Vasilikë! Doktor Filipin desha, është aty?

VASILIKA. Këtu. Ç'të ka ndodhur?

GRUAJA (*e prerë*). Vajza...

Filipi del në korridor e mban vesh.

Mirëmbrëma, doktor. (*I afrohet.*) Për ju erdha. Kam vajzën shumë sëmurë...

FILIPI. Ashtu?! Ku banoni ju?

VASILIKA (*shpejt*). Po është Lumturia, more Filip. Banon dy kate poshtë nesh. (*Gruas.*) Është pak i hutuar sonte.

FILIPI (*i jep dorën*). Vërtet nuk ju njoha. Më falni. Po ç'ka vajza?

GRUAJA. Ka ndonja dy orë që qan nga një dhembje koke. I vë termometrin, tridhjetë e nëntë e dy vija. E mbytën të vjellat. Mendja i humbi, flet përcart. I telefonova urgjencës, po thashë që, sa të vijnë ata...

VASILIKA. Shko, Filip.

FILIPI (*pa lëvizur nga vendi*). Po ç'ka ngrënë?

GRUAJA. Për drekë kishim peshk. Mbasdite do li me shoqet dhe kishte ngrënë një pastë...

FILIPI (*Vasilikës*). Më bjer pak pardesynë. (*Gru-*

as.) Mos u shqetëso, erdha. (*I thërret Vasilikës*). Edhe çantën e veglave.

GRUAJA. Faleminderit shumë!

Vasilika ndihmon Filipin të veshë pardesynë. Gruaja del. Filipi merr çantën e del pas saj. Vasilika mbyll derën. Nga dhoma tjetër hyn Nora.

NORA. Mama, kush ishte sëmurë?

VASILIKА. Çupa e Lumturisë, asaj që banon në katin e parë.

NORA. Ua, Lindita! Po unë e takova qëpari, ajo ishte shumë mirë. Vajti babi ta shohë?

VASILIKА. Vajti, vajti, po eja më ndihmo.

NORA. Do të vete pak te Lindita. (*Bën të dalë me vrapi*)

VASILIKА. (*i thërret*). Prit! Ç'punë ke atje?

NORA. Po e kam shoqe, moj mama!

VASILIKА (*e ndërpret, me inat*). Pa rri aty! Kush e di q'sémundje ka. Apo do të të ngjitet. Hajde, shko të grish patatet!

NORA (*pa qejf*). Oh, edhe ti... (*Shkon në dhomën tjetër*.)

Bie zilja e derës. Vasilika shkon ta hapë. Hyn Trifoni, i pasuar nga e shoqja, Lena.

TRIFONI (*i jep dorën Vasilikës*). Mirëmbrëma!

VASILIKА. Urdhéroni, urdhéroni!

LENA. Si je, motër? (*E puth me dashuri*.)

Trifoni, Lena dhe Vasilika hyjnë në dhomë.

TRIFONI. Filipi s'paska ardhur?

VASILICA. Këtu është, po e thirrën urgjent te një i sëmurë.

LENA. Sa mirë bën Filipi që nuk shkëputet nga vizitat.

VASILICA. E kemi komshi, po s'ka ç'i duhen vizitat Filipit. Le që s'ka as kohë...

TRIFONI. Jo, kunatë, jo. Filipi ka qenë mjek i zoti, pa e vunë aty. Po jo që të lërë zanatin. Më den-dur të shkonte te të sëmurët, më dendur.

Bie zilja e derës. Nga dhoma tjetër del Nora me vrap dhe hap derën. Hyn Filipi.

NORA. Baba, ç'kishte Lindita?

FILIPI. Hiçgjë s'kishte. (*Duke hequr pardesynë.*) Kush ka ardhur?

NORA (*i merr pardesynë*). Xhaxhi Trifoni me tetë Lenën.

Filipi hyn në dhomë

FILIPI. Si u ngrysët? (*I jep dorën Lenës*). Si i keni fëmijët?

LENA. Mirë, faleminderit!

TRIFONI (*i jep dorën, i gëzuar*). Kaq kohë që s'të kam parë me stetoskop, o Filip! Më mori malli.

FILIPI. S'të lënë punët të mbash këtë, Trifon, jo! (*Ulet.*)

TRIFONI. Po pse, ata të tjerët atje te ti, që e mbajnë, pa punë qenkan? (*Me qortim.*) Për punë ka lindur njeriu, Filip!

VASILICA (*Filipit*). Ç'kishte ajo vajza e Lumburisë?

FILIPI. Helmim nga ushqimi. I dhashë ca la-

vazhe. Thirra dhe një infermieri të lagjes për një dy injeksione.

LENA. Shyqyr që ndodhe këtu.

FILIPI. I lashë një fletështrimi, po ndonjë gjë urgjente s'kishte. (*Trifonit.*) Po hë, o Trifon, ç'na thua?

TRIFONI. Ç'të të them? Me shërbim kam qenë këto kohë. Më kënaqet shpirti kur shoh arat... Shkova një ditë në një kooperativë, misri qe bërë det, po ç'thu se kish ndodhur? Një pjesë ua kishin zënë shirat jashtë e kishte nisur të mbinte. Në zemër të pikonte. S'na mjaftuan depot, thanë. Justifikim është ky?

FILIPI. Kjo është negligjencë e pafalshme. Të isha unë, e fusja në burg atë kryetar.

TRIFONI. Mor, po misri iku se iku! Të merren masat nga fillimi, jo nga fundi.

Bie dera. Hyn Llukë Karakolli.

FILIPI (*ngrihet nga vendi*). O, kush na erdhi!

TRIFONI (*ngrihet me gëzim*). Ku je, more Llukë Karakolli!

LLUKA (*pa i dhënë dorën askujt; Trifonit*). Shkova në shtëpinë tënde. Fëmija më thanë se je këtu. (*Vështron rrrotull.*) Gëzim kush ju sheh. Gjithë bashkë, me mbrothësi. Keni sebep për këtë gosti?

VASILIKA (*i jep karrigen*). Urdhëro, ulu! S'kemi gosti. Ka ardhur nëna nga Peshkopia dhe u mblodhëm.

LLUKA (*i gëzuar*). Dadë Dhoqina? Ku është?

FILIPI. Ka shkuar në teatër me vajzën. Vijnë tanë.

LLUKA (*ulet*). Kuvendi i mbarë, bukë në arë!

Kur mblidhet në kuvend vëllazëria, në s'bëhet buka, krushqia. E fejuat çupën, a jeni më të?

VASILIKÀ. As e fejuam, as jemi më të.

TRIFONI. Po si janë andej? Ç'thotë kryetari?

LLUKA. Mirë fare. Më dërgoi për në seminarin e agronomëve. Kam ardhur me Rasimin, agronomin. Shkëmbim eksperience, dy javë. (*Filipit.*) Edhe me ty kisha pak punë, o Lipe.

FILIPI. Ç'punë?

LLUKA. Ta them më vete. (*Vasilikës.*) Ti, Vasilikë, tët motër mirë e kishe. Të bën të fala. Sipas fjalës, dërgon këtë. (*I jep një shishe.*) Këtë e keni nga unë, raki fshati, e kam zier për qejf. (*I jep shishen tjetër.*) Rakia dezinfekton gurmazin, vaji lehtëson gazin. Të dyja duhen.

Bie zilja e derës. Vasilika është e zënë me rregullimin e shisheve. Lena shkon hap derën. Në korridor hyjnë Dhoqina dhe Etleva. Në dhomë hyn Nora me pjatat e sallatës. E vë re Llukën, po nuk ia var.

FILIPI. Jepi dorën mikut, Nora.

NORA (*pa qejf*). Ç'mik? Ky është Lluka.

TRIFONI. E në është Lluka, çfarë? Mësohu të silleh!

LLUKA. Paçka, paçka!

FILIPI (*i vjen zor, Norës*). Ti s'ke bërë ndonjëherë kështu, C'pate sonte?

LLUKA. Po beqëm dhe më ka harruar. Ke vjetë që s'vjen në behar andej nga ne.

Nora shkon matanë. Hyn Etleva.

ETLEVA. Mirëmbrëma! (*Vë re Llukën, gjithë*

*gëzim.)* Dajë Lluka! (*I sulet, e përqafon.*) Si je, dajë Lluka?

LLUKA (*me mall*). Etlevë, moj çupë e Llukës. I mban mend bilbilat që të bëja? Të mësova dhe fyellin.

ETLEVA. S'i mbaj mend?! Ato s'i harroj kurrë, dajë Lluka. (*E përqafon përsëri.*) As leqet e mulle-njave, as shportat e kapelet e kashtës.

Hyn Dhoqina me rrobat e daljes.

DHOQINA. Pa shih kush na paska ardhur! Ku më je, more Llukë trimi!

LLUKA (*i jep dorën*). Eh, moj dadë e Markut! S'më besohet se do të ikësh. U mësuam, një jetë e tërë...

DHOQINA. S'do të lidhem me zinxhirë këtej, more Llukë. Kur të dua, vij.

LLUKA. Të vish, thua? Po të lë Lluka pa marrëty? Le që nipër e mbesa ke plot andej.

DHOQINA. Po si janë andej? Marien e ke parë? (*Ulet.*)

LLUKA. Një ditë pashë së largu një gjë të trashë e i fola, po ç'e do, na qenkej një fuçi, s'qenkej Maria.

LENA. Si ishte shfaqja, moj nënë?

DHOQINA. Mirë, mirë. Një partizan, iu bëftë nënia, toidhio si Marku, i gjatë e i hollë. Sytë xixa i nxirrin. S'durova dot, qava. (*Etlevës.*) Dhe ti, moj Evë, s'bëre mirë që më fole.

ETLEVA. Po ti qave me të madhe, moj gjyshe.

DHOQINA. M'u bë lëmsh në zemër. Po këta kastile të ma kenë bërë? — thosha. Djali toidhio si Marku. Ja, kaq do të ishte tanë, trimi i nënës. (*Shë-*

*non nga Lluka.)* Ç'shoqëri kanë pasur bashkë, ç'shoqëri...

LLUKA. Ishim shokë për kokë. (*Me mall.*) Kujtimet e vjetra, si vera e vjetër, më shumë kohë të kalojë, më të shtrenjta bëhen...

VASILIKA. Urdhëroni tani! Zini vendet në tavolinë!

ETLEVA. Pastaj shkuam me gjyshen të hanim akullore.

DHOQINA. Akulloren s'e hëngra, po piva një filxhan çaji me kafe frëngu.

Të gjithë zënë vend në tavolinë. Vasilika, Etleva dhe Nora shërbejnë me shkathësi.

FILIPI. Ç'do pish ti, nënë, birrë apo verë?

DHOQINA. Raki të fortë.

VASILIKA. Dhe aq e fortë s'është. Filipi e pî me ujë.

LLUKA. Hapni shishen që solla unë. Ta jep në çakën e kokës, frymën flakë ta nxjerr.

Si rregullohen me piye të gjithë, Filipi ngre gotën.

FILIPI. Gëzuashi e mirë se erdhët!

TË GJITHË. Gëzuar! (*Çokin gotat.*)

LLUKA (*i shkel syrin Trifonit.*) Për pak do ta kishim një gëzim, demek një fejesë, paçka, do ta kemi më vonë.

TRIFONI. Do të ishte çarë daullja, o Llukë.

DHOQINA. Gëzim kemi sa s'ka më. Që kur vdiq plaku, s'jemi mbledhur kështu. Të ishin dhe dy çupat, do ta kisha gjithë barkun këtu.

ETLEVA. Të ishte dhe Agroni!

DHOQINA. Zëre se e kemi. Si div, djali i gjyshes. Malet çante dhe të sëmurëve te koka u shkonte. Dhe në vend të Markut ja, më ka ardhur Lluka.

VASILIKА (*duke shërbyer*). Të donte Agroni, jo sonte, po ç'do natë do të ishte këtu.

TRIFONI. Dhe, meqë s'është çdo natë, të mos jetë as më të rrallë?

DHOQINA. Në i është mbyllur dera çunit, s'i është mbyllur zemra, de.

FILIPI. Ju mbeti mendja, moj nënë. Neve s'na dhimset Agroni?

DHOQINA. (*ashpër*). Po njerëzit atyre maleve nuk të dhimsen?

#### Heshtje

TRIFONI (*i rreh shpatullat Dhoqinës*). Mirë, nënë, mirë. Edhe Lipja, se i janë dhimsur njerëzit, i ka bredhur ato male. Gëzuar!

Për disa momente sundon heshtja. Skena errësohet nga-dalë. Kur ndizen dritat, darka ka mbaruar.

FILIPI. Nora, merre violinën.

DHOQINA. Ç'violi? Të na lodhë kokën me ato giu-viu-giu-viu?

LLUKA. Mos u mërzit ti, dadë e Markut, se kam marrë fyellin me vete unë. (*Etlevës*) Të lutet Lluka, ma merr pak, në torbë e kam.

Etleva shkon në një nga dhomat.

DHOQINA. Hë më të lumtë, more Llukë!

LLUKA. Eh, kur luftonim me Markun... Pas betejës më thoshte: «Pa merre, o Llukë, atë fyellin...»

Hyn Etleva, që i jep Llukës fyellin.

DHOQINA. Pa jepi, o Llukë.

Lluka ia merr një melodie baritore. Të gjithë e dëgjojnë me kënaqësi.

DHOQINA (*ndez llullën*). Ti, Llukë, ke humbur për këtë të shkretë muzikë.

LENA. Po ti sikur e le llullën, moj nënë.

DHOQINA. Kur më mblidhet lëmshi në zemër, e dua me llullë farmakun.

Vasilika sjell kafetë dhe i shpërndan.

FILIPI (*Norës*). Ti, çupë, mos na rri turivarur, po ngrei pjatat.

VASILIKА. Nëna për të mirë të foli.

LLUKA. Fjala e të madhit është si uji përbimën.

Nora ndihmon të ëmën në heshtje.

DHOQINA. Më shumë të na kishin folur pleqtë tanë, më mirë do kishin bërë.

LLUKA. Se sheqeri i shumtë të prish dhëmbët.

Befas sirena e autoambulancës. Trifoni dhe Lena ngrihen.

Filipi rri si i mpirë.

DHOQINA. Po kjo kështu?

VASILIKA. Si makina e spitalit, më duket...

FILIPI. Të jetë urgjencia, thua? (*Pak i shqetësuar.*) Pse të vijë қaq shpejt?...

LLUKA. Ç'ka ndodhur?

FILIPI. Pa zbrit poshtë, Vasilikë, e shih mos po marrin atë vajzën (*Pauzë.*) Çudi! Unë dhe e stabilizova...

Vasilika del me të shpejtë.

DHOQINA. Ç'është kjo vajzë?

LENA. Ajo që vizitove ti, Filip?

FILIPI (*ngrihet, shkon sheh nga dritarja.*) Ajo do të jetë. (*Shqetësohet, po e mban veten.*) Ishte helmuar nga ushqimi, po, si duket, do të jetë rënduar papritur.

TRIFONI. Helmim?

FILIPI. Ashtu m'u duk...

Vasilika hyn me të shpejtë. Dëgjohet zhurma e autoambulancës që niset.

(*Me padurim*) Hë?

VASILIKA. E quan në spital.

FILIPI. Pyete ç'thanë?

VASILIKA. Ku dinin gjë ata!

TRIFONI (*Filipit*). Telefonoi spitalit.

FILIPI (*si me vete*). Si u keqësua kështu?!

TRIFONI. Po ikim tani, se na presin fëmijët. Ti, Llukë, po vjen?

LLUKA. Erdha, po kisha një hall për te Filipi.

FILIPI. Po ma thuaj, de.

LLUKA. Mirë, po këtej, mënjanë.

Trifoni, Lena dhe Vasilika dalin në korridor e presin. Lluka dhe Filipi bëjnë pak mënjanë.

FILIPI. Ç'ke?

LLUKA. Ai kryetari që hoqën, shkon e ngatërron doktorin, një çun i ri ai, e i thotë: «Lluka ka rënë nga kali, a ka dëshmi që është mirë nga koka?» As kryetari i ri, as doktori s'më kërkuau gjë, po unë them të kem një dokument se s'i dihet. Ç'thua, më jep dot një raport që jam mirë?... Demek, një vërtetim...

TRIFONI (*që ka dëgjuar*). Po të thashë, o Llukë, ç'bëhesh merak! Ç'është ky raport?

LLUKA. Po ta kem me shkrim, o Trifon...

FILIPI (*Trifonit*). Meqë ka ardhur, le të bëjë një kontroll, po s'është puna te raporti, jo.

Filipi dhe Lluka dalin në korridor. Mysafirët përshëndeten dhe dalin. Hyn Dhoqina, ulet në kolituk e ndez llullën.

Etleva shkon tek ajo.

DHOQINA. Kisha nijet të shkoja në fshat, po qëndrova. Te Trifoni marr vesh se yt atë e jot ëmë vërtet na paskeshin shkuar në Breg.

ETLEVA. Për punën e shtëpisë shkuani.

DHOQINA. I dhashë karar pér shtëpinë. Me njëqind mendje jeshë.

ETLEVA. Po ti mos i merr para Kasëmit, moj gjyshe.

DHOQINA (*e menduar*). Fshatit dhe ia keshë falur, po i dhashë llafin Kasëmit. Po pako gjë do t'i marr, pako gjë.

ETLEVA. Mendohu dhe një herë, gjyshe.

FILIPI. Shkoi vonë, Etleya. Nesër do të shkosh në punë.

ETLEVA. Ja, u ngrita. (*Përqafon Dhoqinën.*) Natën e mirë, gjyshe! (*Shkon matanë.*)

DHOQINA. Gjumë të ëmbël, bijë!

FILIPI (*s'di si t'ia nisë*). Këta tre vjet që kaluan pas vdekjes së babait, me zemrën helm na vajtën.

Vdekja mënjanë, po edhe ca fjalë që kemi këmbyer...

DHOQINA. Këto i shkoqitëm mbrëmë te Trifoni. Shkuan e vanë ato.

FILIPI. Veç mos të të ketë mbetur hije në zemër. Se dy vjet si të huaj...

DHOQINA. Të thashë: me djalin bëre gabim... Ma theve zemrën.

FILIPI (*shpejt*). Jo, nënë, jo... Për ata fëmijë po bëhem copë! Siç jeni bërë edhe ju pér ne. Kështu shkon kjo...

DHOQINA. Mirë, mirë, po ç'kishe?

FILIPI (*e ul*). Po ja, pér shtëpinë... (*Ulet dhe vetë.*) Mos i tëhuaj fëmijët dhe nipërit e mbesat nga ajo vatër, nënoke. Kemi zemrën atje...

DHOQINA. Shtëpia nuk mbahet, Filip. Që kur iku Trifoni, si e shkretë më duket. Kur s'do të rrrijë njeri, ç'ta duam?

FILIPI (*shpejt, me të mirë*). Po çfarë, ta shesim? Të shesim kujtimin e babait, kujtimin tënd? Tek ajo shtëpi rroni ju, moj nënë. Me para maten këto gjëra?

DHOQINA. Jo, jo. Edhe llafin të mos ia kisha dhënë atij tjetrit, shtëpinë s'e mbaja. Kjo punë ka mbaruar.

Pauzë.

FILIPI. Domethënë e paske vendosur. (*Pauzë e shkurtër.*) Je keq për para, a si?

DHOQINA (*e sheh në sy*). Jo, bir i nënës, s'e kam atë hall. Po ti, ku qëllon kështu?

FILIPI (*ashpër*). S'qëlloj gjékundi, po më dhibet shtëpia. Të paktën thuaj: më duhen para, dhe pikë.

DHOQINA. E nga e di ti që m'u dashkan para?

FILIPI. S'të duhen ty, i duhen Trifonit. Djalë e ke e do ta ndihmosh, po, të paktën, thuaje.

DHOQINA. More bir, po të ka mbajtur ndonjë të fshehtë nëna ty?

FILIPI (*prerë*). Mirë, mirë. Sa do t'i marrësh Kasëmit?

DHOQINA (*prerë*). Pak gjë do t'i marr. (*Ngrihet*)

FILIPI (*ngrihet*). Sa? Njëqind e pesëdhjetë? Dyqind? (*Shpejt*.) Aq para t'i jap unë, që sot. Mbaje shtëpinë.

DHOQINA (*e habitur*). Qenke bërë paralli? (*Pauzë e gjatë*.) Mirë, bir, mirë. Nuk do ta shes.

FILIPI (*me dyshim*). E ke me gjithë mend, apo...

DHOQINA. Filip, Filip!... Qysh qenke bërë kështu, more bir! Ai tjetri është ngushtë, ti...

FILIPI (*ashpër*). Qysh qenkat bërë?

DHOQINA. Njëherë e një kohë rrobën nga trupi e hiqje dhe ia jepje tjetrit... Qysh kuvëndo ke kështu, more Lipe!...

FILIPI. C'ke, moj nënë? C'ke?

DHOQINA. S'je më i vogël, po do të ta jepje një flakurimë! Po edhe dora m'u plak tanë. (*Ndez llullën*.)

FILIPI (*i del përpara*). Po ç'po bëj, xhanëm?!  
Do të heqim dorë nga jeta, apo si?

DHOQINA (*ashpër*). Të rrrosh, bir i nënës, të rrrosh!... (*Bën të dalë*.)

FILIPI. Nënë, të lutem...

DHOQINA (*e shikon ngultas*). Nuk të marr vesh:  
mos nuk do që të vij unë këtu dhe të rri në fshat për  
të mbajtur shtëpinë hapur?

FILIPI (*i shkon pas*). Ç'flet, moj nënë!

Pauzë.

DHOQINA. Dëgjo, bir, për hatër të Agronit kam  
ardhur këtu.

Filipi rri si i mpirë.

(*Thërret*) Ku je, moj Evë? Atë librin për Skënder-  
beun ku ma le? (*Hyn në një nga dhomat*.)

ETLEVA (*Nga dhoma tjetër*). Tek abazhuri,  
gjyshe.

Hyn Vasilika me fshesë në dorë.

VASILIKA (*me padurim*). Hë?

FILIPI (*ashpër*). Të lutem, Vasilikë, më lër të  
qetë. Më lër të qetë, dëgjon?

VASILIKA. Ç'pate?

FILIPI. Se po pëlcasim trutë e po rrahim ujë në  
havan. (*ulet; zë kokën me duar*.) Rrezik të më shpër-  
thejnë damarët... Sillmë një aspirinë. (*Bërtet*.) Dhe  
punën e shtëpisë mos ma zër më në gojë, dëgjon?

Vasilika e shikon si e hutuar e del.

(*Shkund kokën*) Ç'dhembje... (*Pauzë*.) Të rrrosh, të rrrosh...

Hyn Vasilika, i jep aspirinë dhe një gotë ujë.

(*Pi aspirinën*.) Dëgjon? Për punën e shtëpisë të mos më thuash më asnje fjalë!

VASILIKА (*si me të qarë*). E mora vesh. Mendon yt vëlla pér të.

FILIPI. Mjaft (*Ngrihet*.) Të kam thënë që as tim vëlla të mos e zësh më në gojë! (*Ecën pak*.) Ç'u bëmë kështu? (*Pauzë*.) Të rrrosh... (*Kthehet nga Vasilika*) Dëgjo, si e ka emrin ajo vajza e Lumtos?

VASILIKА (*me përbuzje*). Të mbetën hallet e botës pa zgjidhur!

FILIPI. Pse më bën të zgjoj Norën?

VASILIKА. Lëre çupën të flejë. Lindita e quajnë.

FILIPI. (*shënon në një copë letër*). Lindita kush?

VASILIKА. Bardhi. Po dëgjo...

FILIPI. Mjaft! Sa të telefonoj unë, nxirr dosjen numër gjashtë e vëre mbi tavolinë.

Filipi shkon te telefoni. Vasilika shkon e kërkon në raftin e dhomës.

(*Në telefon*.) Alo. Infektivi? Ju lutem, pyesim pér një vajzë trembëdhjetëvjeçare, Lindita Bardhi, shtruar urgjent me intoksikacion. (*Pauzë*.)

Nga dhoma përballë del Etleva e mban vesh.

Si, si? Meningjit? Jo... Mos e keni gabim? (*Pauzë*.) Shumë rëndë. Oh! Babai jo... po një i afërm. Ju fa-

leminderit! (*Mbetet i shtangur; me vete.*) Meningjit?!  
Po kjo kështu?! Oh, koka... (*Mbyll telefonin.*)

ETLEVA. Ajo vajza, baba? Po ti the...

FILIPI (*s'e ka vënë re, si i trembur.*). Po ti?...  
S'po fle?

ETLEVA (*i afrohet*). Baba, dikur ty s'të ndodhte  
kurrë gjë e tillë...

FILIPI (*me nxitim*). Unë e mora për... çudi, po  
ato shenja klinike...

ETLEVA (*e vendosur*). Po sikur të kishte vde-  
kur?

FILIPI. Etleva, të lutem... Është vonë dhe kam  
ende për të punuar.

ETLEVA. Të punosh, baba. Po jo vetëm statis-  
tikat e vdekjeve. Jo vetëm statistikat e vdekjeve...

Për disa çaste Filipi e shikon i vrerosur, pa ditur ç'të thotë.  
Po shpejt e mbledh veten dhe hyn në dhomë. Etleva vë  
dorën në faqe, mendohet pak e shkon matanë.

VASILIKA (*duke kërkuar në raftin e dhomës*).  
Ç'numër the?

FILIPI (*ulet në tavolinë, mbështet kokën mbi  
bërryla*). Numër gjashtë. Rafti i dytë, nga e majta.

VASILIKA. Nga e majta?! Po ti ke thënë se ato  
të krahut të majtë janë të vitit të kaluar e s'duhën  
më. Kam ndezur zjarrin me to.

FILIPI. Je në vete?!

VASILIKA (*e trembur*). Mos bërtit, se aty do  
të jenë. (*Shkon në raftin e korridorit, kërkon, kthe-  
het me një dosje.*) Ishte atje, e flamosura. Më ngriu  
gjaku. (*E vë mbi tavolinë.*)

Filipi vështron dosjen si i hutuar. Vasilika s'di ç'të bëjë.

FILIPI. T'i marrë djalli, t'i marrë!

VASILIKA. Ç'flet?

FILIPI. E ç'djall studime bën Hyseni me këto?!  
(E merr dosjen në dorë dhe e përplas në tavolinë; me tjetër ton.) Të ngatërrrosh shenjat klinike të meningjitit me ato të helmimit! (Ngrihet, merr dosjen në dorë, ecën lart e poshtë.) E megjithatë njerëzit ende thonë se doktor Filipi është mjek i mirë. Ptu!  
(Flak dosjen në një qoshe, fletët shpërndaken, Vasilika bërtet.)

VASILIKА. Filip...

FILIPI (shkon pranë raftit në korridor; që aty). Vasilika, çelësin.

VASILIKА (te dera, shënon nga fletët e shpërndara). Po këto?

FILIPI. Çelësin, të them!

Vasilika shkon te bufeja, merr çelësin e ia çon me të shpejtë.

(Duke kërkuar librat.) Më bëj një kafe të fortë e shko të flesh. (Nxjerr nja dy libra, shkon në dhomë, ulet në divan, hap njërin.) Ta kem pasur vërtet gabim? (Lexon.)

## AKTI I TRETE

### Tabloja e shtatë

Zyra e Filipit. Në raftin e librave vihet re një rregull i madh, ndërsa në tavolinë librat janë shpérndarë andej-këtej. Hyn Filipi, lë çantën mbi tavolinë, ulet dhe zhytet në lexim.

Pas pâk hyn Etleva.

ETLEVA (*me gëzim*). Mezi të gjeta! Shkova në spital, më thanë se sapo kishe ikur.

FILIPI. Po të shoh të gëzuar, Etlevë.

ETLEVA. Po, baba. Sot m'u botua artikulli... artikulli i parë. (*Nxjerr nga çanta një gazetë, e hap, ia tregon.*) Ja.

FILIPI (*e merr, kërkon artikullin me sy*). Po, ja... Mirë, urime! (*Duke i hedhur një sy*.) Është ai që lexova në dorëshkrim, apo jo? Për uzinën?

ETLEVA. Po, ai.

FILIPI (*ia jep*). Në shtëpi do ta lexoj me nge.

ETLEVA (*e fut në çantë*). Si u bë çupa e Lumtos?

FILIPI. Në spital takova mjekun, biseduam gjatë. Analizat japid shenja mjaft të mira. I bënë një punksion tjetër, do ta marrë veten shpejt.

ETLEVA. Sa mirë! (*Sheh nga librat mbi tavolinë*.) Po këta libra?

FILIPI. Lexova disa materiale të kohëve të fun-

dit... Kanë të dhëna interesante mbi disa forma të meningesit.

Hyn Petriti.

PETRITI. Tungjatjeta, Filip! (*Drejtohet nga ai, vë re Etlevën.*) Si je, Etlevë? Ç'thotë uzina? (*I jep dorën me gjallëri.*)

ETLEVA (*me gëzim*). Tungjatjeta! Si ia kaluat?

PETRITI. Bukë e vjetër si bukë e vjetër. (*Etlevës.*) Agroni ju bën shumë të fala, ishin mirë.

ETLEVA. Tha se kur do të vijë?

PETRITI (*me tjetër ton*). Agronit i erdhi shumë keq që nuk ia çove librat, Filip. Priste çdo ditë që t'ia dërgoje, po... s'gjete njeri a si? Kishte hasur një rast të rrallë dhe i duheshin.

Heshtje.

FILIPI (*zihet ngushtë*). Kam pasur një lumë me andralla, Petrit. Më ka dalë nga mendja... (*Shpejt, Etlevës.*) Etlevë, mos harro, sa të shkosh në shtëpi, bëji pako, se fundja ia nisim dhe me postë.

PETRITI (*hetues*). Filip, Etleva e shtëpisë është e nja dy fjalë do të t'i them. Agroni ma hapi zemrën. «Babi s'ka dashur të m'i dërgojë, — më tha. — Dhe më vjen çudi, — tha, — si pikërisht babai im mendon se shkenca s'bëhet dot këtej, kur ai vetë dikur...»

Heshtje e gjatë.

FILIPI. Eh, Petrit, kohë të tjera ato... Na shtynte nevoja e ngutshme. Laboratorët atëherë i ngritëm edhe buzë kënetave...

Heshtje.

ETLEVA. Baba, Agroni ka të drejtë...

FILIPI (*s'i vjen mirë*). Rri ti, Etlevë!

PETRITI. Le të flasë. (*Pauzë*.) Këta kanë zërin tonë, Filip.

Heshtje.

FILIPI. Ulu, Petrit, ulu!

PETRITI. Nga Peshkopia erdha me Mëhillin. Të kujtohet Mëhill Ujkaj?

FILIPI. Mëhill Ujkaj. Si s'më kujtohet? Ku është tan?

PETRITI. Në fshatin më të largët, në Zadicë. I shkon një ditë një pacient...

Hyn Mëhilli, një burrë i gjatë, hundëshqiponjë, rrëth të dyzetepesave.

(*Me ton shakaje*) Ja ku na erdhi dora vetë, Mëhill Ujku!

MËHILLI (*sulet nga Filipi*). Filip Sholla, a je burrë i fortë, a jo!

FILIPI (*e përqafon*). Ku je, more ujk mali! Na humbe...

MËHILLI (*i bie në sup*). Se kush ka humbur nga ne të dy, ec e merre vesh, or t'u bëftë axha! (*Me fytyrë nga Etleva*.) Po kjo gocë?

FILIPI. Vajza ime. (*Etlevës*.) Një shoku im i vjetër, Etlevë.

MËHILLI. Ou, ou, sa qenka rritur! (*E përqafon*.) Moj, po ç'm'i ngjake kështu Agronit! Bukur, besa, bukur. Po a më mban mend?

ETLEVA. S'di si t'ju them...

MËHILLI (*Filipit*). Kaq vjet që s'jemi parë, o Filip.

FILIPI. Pa të ulemi njëherë.

Ulen të gjithë rreth tavolinës. Mëhilli u zgjat nga një cigare.

Vite po bëhen, vite... Po ç'na thua? Seç filloi të më tregonte Petriti.

MËHILLI (*si ndez duhanin*). Është një histori, or burrë, që më bëri... të shkundem a... si të të them... Solla një pacient këtu. Ani, shkurt fjalës, dy javë më parë ma sjellin këtë patient në gjendje të rëndë. Më thonë se, duke ecur nëpër oborr, ishte rrëzuar e goditur në kokë. Gjatë natës kishte pasur të vjella e i kishin dhënë shurup me mjaltë për të marrë ca fuqi. Më thonë se, edhe para se të rrëzohej, nuk ndihej mirë. Të nesërmen e natës që ishte rrëzuar, gdhihet me koshiencë gati të humbur. U ndodha ngushtë: kjo gjendje komatoze ishte pasojë e goditjes, apo e ndonjë diabeti? Më duhej një ekzaminim urgjent i gjakut dhe urinës që të vendosja. Një analizë që zgjat vetëm njëzet minuta. Po ç'e do! As disa mjete të nevojshme s'kisha, dhe as tre-katër reagentë... Me një fjalë, asgjë. Isha si në tym, or burra. (*Pauzë*.) Erdhi autoambulanca, po a duhej lëvizur? Se me goditje në kokë... Nejse, në qytet sosi pas disa orësh... Diabet doli. E stabilizuam dhe, së fundi, e sollëm këtu.

ETLEVA. Tani si është?

MËHILLI. Mirë. I duhet të bëjë disa kura të veçanta. Po ç'e do, kur s'i dhashë dot ndihmë urgjente...

FILIFI. (*me qortim*). Po si, more Hill, s'kishe as disa epruveta!

MËHILLI. Eh, more burrë, por edhe bash faji im nuk éshtë. Shty sot e shty nesër, po nuk m'i kishin dërguar... Sa të vijë kontigjenti i ri, më thoshin. Po edhe unë, ama, mund t'i kisha bërë hall disa gjëra... Filip, po dal tani, do të shkoj përsëri andej nga endokrinologja.

FILIFI (*ngrihet*). Eja sonte nga unë.

Ngrihen edhe Petriti me Etlevën.

MËHILLI. Jo, jam nga vëllai sonte. Nesër po dal njëherë andej nga ty. (*Etlevës.*) Mirupafshim, moj gocë e Mëhillit!

ETLEVA. Mirupafshim!

Petriti dhe Filipi përcjellin Mëhillin e pas pak kthehen duke vazhduar një bisedë të nisur që jashtë.

PETRITI. Mirë ata të rrëthit, po Mëhilli? Kishte harruar kérkesat ndaj vetvetes.

FILIFI. Dhe çudi, se Hilli bën shumë pas të sëmurëve! Po edhe ata të rrëthit për një mikrolaborator, mund ta kishin ndihmuar, de.

PETRITI. Ja, si ajo puna e laboratorit të Sukajt. Po s'ia çuat ju, nga do t'i gjejë rrëthi?

FILIFI. Po sikur s'është kaq njësoj! Këtu fjala éshtë për laborator.

PETRITI. Pak mjete kérkojnë dhe ata. E kanë larg spitalin e rrëthit.

FILIFI. Vitin tjetër shohim e bëjmë. Them unë, se Hyseni s'është dakord fare. Tri herë e kam biseduar me të.

PETRITI. Filip, ma ndaj mirë: nuk do ti apo nuk do Hyseni?

FILIPI. Të thashë, more Petrit, ai është kundra. (*Me mërzi.*) Nuk merresh dot vesh me të, jo!

PETRITI. Edhe për çështjen e barnave ai ishte kundër...

FILIPI (*i ndodhur ngushtë*). Po ç'të bëj, kur më vë rregullat përpara?! Jo planifikimi, jo inventari...

Pauzë e gjatë.

PETRITI (*me të butë*). Po mirë, këto rregulla prej graniti qenkan? Nuk ndryshohen këto, nuk u përshtaten nevojave që dalin?...

FILIPI. Po kjo dihet...

PETRITI (*shikon te dritarja*). Dihet! (*Pauzë e shkurtër.*) Po vetëveprimi ku është? Apo kush të dojë le ta marrë inisiativën, veç jo unë!

FILIPI. Po sikur nuk është fjala për inisiativa këtu!

PETRITI. Po, pse jo? Dhe, për të shkulur të vjetëruarën, s'është fjala vetëm për një inisiativë, jo! Sa t'ia fillosh është halli, po kjo kërkon guxim... (*Me të butë.*) S'ka gjë, le të mos i pëlqejë dikujt ky guxim...

Pauzë e gjatë.

FILIPI (*e sheh në sy*). Petrit, mos po bën ndonjë aluzion se unë nuk kam guxim?

Pauzë.

PETRITI. Filip, mbaj mend se, kur ishim studentë, të pëlqente shumë shprehja latine *intelligenti*

*pauca.*<sup>1)</sup> (*Pauzë.*) Edhe Mëhillin sapo e dëgjova... (*Pauzë.*) Po dal tani. (*Bën të ecë, ndalet.*) Po dëgjo, bisedoje edhe një herë me Hysenin. Mirupafshim!

Etleva i kthen përshëndetjen. Petriti del. Për disa çaste sundon heshtja.

FILIPI (*me vete*). Inteligenti pauka...

ETLEVA. Ç'do të thotë kjo, baba?

FILIPI. Kush është i mençur, kupton dhe me pak...

Heshtje e gjatë.

ETLEVA. Baba, unë them që ti, po të mos i kishe humbur lidhjet me klinikën, do ta kishe më të lehtë... do t'i kuptoje më mirë nevojat e saj...

FILIPI (*pa u kthyer nga ajo*). Ku na lënë punët, moj Etlevë!

Nga dera që të nxjerr në oborr, hyn Llukë Karakolli.

LLUKA. Tungjatjeta, Lipe! (*Vë re Etlevën*). Etlevë, moj çupë e Llukës, si më je? (*I jep dorën*.) Sikur po të shoh të mërzitur.

ETLEVA. Jo, dajë Lluka, jam e gjuar. Sot m'u botua artikulli i parë.

LLUKA. Gëzim e ngazëllim! Artikulli i parë, si dashuri e parë; njëra stamposet në zemër, tjetra në gazetë, po as njëra, as tjetra nuk shlyhen për jetë. Gëzim e ngazëllim!

ETLEVA. Po dal tani. Do të shkoj pak nga spi-

---

Shqiptohet *inteligenti pauka*.

tali tē shoh Linditën. (*Llukës.*) Sonte, bashkë me gjyshen, do tē dalim, mirë? Do tē shkojmë nga liqeni.

**LLUKA.** Shkojmë, moj bijë, shkojmë, pse jo?

Etleva del.

(*Filipit.*) Shkova tek ai doktori. Më pa mirë e mirë, po vërtetim s'më dha. Ç'të duhet vërtetimi, më tha, ti i ke nervat më tē forta se tē miat!

**FILIPI** (*s'e ka mendjen aty*). Mirë, o Llukë, mi-ri... Llafosim në shtëpi.

**LLUKA.** Si tē kesh qejf. (*Pauzë.*) O Lipe, dëgjo-va nga Trifoni se keni ca burokracira këtej. A thua tē jenë tē vërteta?

**FILIPI** (*e sheh në sy*). Epo, dhe tē kulluar fare s'jemi, more Llukë.

**LLUKA.** Shumë ndriçim e vërnik ke këtu, o Lipe. (*Ul zërin.*) Drita e tepërt t'i vret sytë. Dil që t'i çlodhësh, dil... (*Tund kokën.*)

**FILIPI** (*jo shumë i qetë*). Kështu, o Llukë, eja në shtëpi.

Hyn Hyseni që i hedh Llukës një vështrim tē ftohtë, pa e përshëndetur.

**HYSENI** (*lë çantën mbi tavolinë; me zë tē lartë*). Po ky? Kontroll punëtor?

**FILIPI** (*me zë tē ultë*). Aty afër. Mos i jep mu-habet, se ta skuq mirë.

**HYSENI** (*me tallje*). Ky?! (*Ulet, ndez një ciga-re.*) Kanë filluar t'i shtojnë zhurmat disa persona këtu, Filip. Gazetari s'kishte ardhur vetë, e kishin thirrur. Kuptohej ajo, s'mund tē ishte e rastësishme ardhja e tij...

LLUKA (*Hysenit*). Po ju, shok, doktor jeni?

HYSENI (*kthehet nga ai*). Po. Përse pyet?

LLUKA. Thashë... se doktorët çoku kanë kulturë, ia japid një njatjeta tjetrit!

HYSENI (*fryhet; Filipit*). Nga është ky biçim personi?

LLUKA (*ndërhyn*) Unë jam, o biçim doktori, andej nga fjala kërcet si pushka. (*Përkulet në shënjë respekti*.) Nderimet e mia! (*Filipit*.) Lipe, po të vij në shtëpi. (*Bën të dalë*.)

HYSENI (*me përbuzje*). Ç'tip...

LLUKA (*e dëgjon, ndalet*). Tip topi e top baruti. (*Bën një hark me dorë*.) Rrota e prishur bën më shumë zhurmë. Nderimet e mia! (*Del*.)

HYSENI (*i habitur*). Ç'është ky?

FILIPI. Një miku im. Kështu e ka, ta këput.

HYSENI (*e mbledh veten*). Ku e kisha fjalën? (*Pauzë*.) Hë, mora vesh se ai gazetari na paska qendrisur një artikull të fortë kundër nesh... domethënë kundër degës sonë. Do ta batojë këto ditë.

FILIPI (*tund kokën*). Dhe pa gjë s'jemi, Hysen...

HYSENI. Domosdo, edhe ndonjë të metë e kemi. (*Shpenguar*) Po do t'i ndreqim, do t'i ndreqim. Dihet, kritika në të mirë të punës është. Edhe ekipi i kontrollit punëtor, nëse do të vijë, si ç'flitet, mirë se të vijë. (*Ul zérin*.) Mundet që në ekip të ketë edhe njerëz nga spitalet e qendrës. Duhen takuar disa persona, të shohim ç'bëhet... Duhet menduar për një farë mbështetjeje. Dëgjo, (*i jep një letër*) do të më hartosh një relacion urgjent në lidhje me këto pikat. Në orën dymbëdhjetë do t'i shqyrtojmë në mbledhjen e degës.

FILIPI. (*duke parë në letër*). Ç'janë këto?

HYSENI. Ndoshta do të na duhet të botojmë një përgjigje në gazetë. Byroja e Partisë ka vendosur të bëhet një mbledhje me kryetarët e degëve të drejtorive. (*Pauzë.*) Atje do të flasim edhe ne, kuptohet... (*Ngrihet, shëtit lart e poshtë.*) Do të pranojmë disa të meta, do të bëjmë edhe autokritikë, kuptohet... Po më e rëndësishme është të argumentojmë para të gjithëve mbarëvajtjen e punëve në degën tonë, kupton? Mbarëvajtjen e punëve. Se disa njerëz po duan të na hapin telashe dhe ne duhet të dimë t'u kundërpërgjigjemi.

FILIPI (*thatë*). Jepja më mirë Islamit. (*I zgjat letrën.*)

HYSENI (*i shtyn dorën*). Ç'Islam?! Këtu duhet krijim, fantazi. (*Pauzë e shkurtër.*) Braunhilli, poet e filozof i njojur i kohës sonë, thotë: «Zgjero vetveten, për të kuptuar se bota s'është aq e egër sa duket, vetëm kështu nuk do të kesh frikë nga ajo». Prandaj...

FILIPI (*i mërzitur*). E ç'na hyn në punë se ç'thënka një farë Braunhilli!

HYSENI (*rreptë*). Thellohu, Filip, thellohu... (*Bën të dalë.*)

FILIPI (*i shkon pas*). Një minutë. Ata të Sukajt na shkruajnë prapë për atë punën e laboratorit.

HYSENI (*ngryset*). Për atë punë u sqarove, më duket! (*Rreptë.*) S'do t'i biem gjithnjë në një vrimë.

FILIPI (*prerë*). Është e treta letër që dërgojnë. S'bëjmë ndonjë shkelje, po t'i ndihmojmë.

HYSENI. Ç'janë këto koncepte?! Si s'na qenka shkelje?

FILIPI (*i vendosur*). Hysen, dikur, në një zonë

të Myzeqesë, vetëm me ndihmën e ca epruvetave primitive u kemi shpëtuar jetën dhjetëra njerëzve...

HYSENI (*ashpér*). Tani s'janë ato kohëra dhe më duket se këtu s'bëhet fjalë për punë epruvetash. Po, me ç'shoh unë, ti nuk po e vlerëson si duhet situatën. (*Ngre zërin.*) Pikërisht tani, kur disa njerëz po prepatiten të na e japid nofullave publikisht, ti kërkon t'u japësh fakte të reja. Për punën e barnave e shkele urdhrin, po tani, të lutem... (*Matet të dalë.*)

FILIPI (*shpejt*). Të lutem, prit pak. Kam dhe unë dy fjalë.

HYSENI (*ndalet, e vështron si me çudi*). Pa hë?

FILIPI. Këta njerëz që thua se po prepatiten të na godasin publikisht, kanë kohë që kanë filluar të shprehin shqetësimë lidhur me punët e degës sonë. Dhe na kanë kritikuar hapur, mua, ty, Islamin... Kemi qenë ne ata që s'ua kemi vënë veshin fjalëve të tyre, i kemi hedhur matanë, si i thonë... Dhe tani, (*tund kokën*) me këto mbrojtje të stisura... (*tund letrën*) s'do ta kemi aq të lehtë...

HYSENI (*shtang për një çast*). Mos mendon ti se duhet të gjelltisim çdo gjë që thonë... Petriti, të tjerët e ku di unë?

FILIPI. Hysen, kemi kohë që punojmë bashkë dhe kemi arritur ta njohim sadopak njëri-tjetrin.... Ne i kemi mbajtur gjërat brendaperbrenda degës, i jemi trembur publicitetit, i kemi rrahur shpatullat njëri-tjetrit e... jemi struktur brenda lëkurës sonë... Po kështu... nuk mund të vazhdojmë më gjatë... Për shumë arsyе. Jo dhe jo!

HYSENI (*i shtangur*). Filip... Mos ke ndër mend të më heqësh qilimin nga... mbrapa shpine?

Pauzë.

FILIPI. Jo, Hysen. Ne do t'i dalim njéri-tjetrit përballë. Po... nuk dua të zgjatem. Desha vetëm të të thosha që... (*rizgjat letrën*) për të hedhur poshtë këto gjëra që ngrihen këtu... mund të merresh ti vetë ose dikush tjetër nga dega jonë. (*Prerë.*) Unë nuk pranoj.

HYSENI (*çakarrit sytë*). Ashtu?! (*Ia rrëmben letrën.*) U kalb shtylla ime tani, s'mbështetesh dot? Hë, hë...

FILIPI. Dhe, e dyta, për laboratorin e Sukajt unë do të vendos vetë.

HYSENI (*e sheh meurrejtje*). Mblidh mendjen, se po luan me zjarrin! Këto sfida, edhe pse mund të jenë një lajthitje e rastit, do të të kushtojnë rëndë! (*Përpigjet ta zbusë zërin.*) Mendohu, kthjellohu dhe eja të bisedojmë përsëri. (*I afrohet.*) Veç... mos kujto se më ke njobur, siç the pak më parë. (*I afrohet fare pranë.*) S'të kam lënë të më njobësh deri në fund, Filip, jo! (*Bën të dalë, po kujtohet që ka lënë çantën e kthehet.*)

FILIPI. Jo, Hysen. Përkundrazi, kam filluar të të njoh...

Hyseni i hedh një vështrim të ngrysur e del me rrëmbim, pa iu përgjigjur.

### Tabloja e tetë

Dhomë e apartamentit të Filipit.  
Dhoqina, ulur në kolktuk, është e zhytur në lexim. Hyn Vasilika me një filxhan kafe në dorë.

VASILIIKA. Kanë filluar mbledhjet nga çdo anë.

Ne do ta bëjmë javën tjetër. (*I vë kafenë përpara.*)

DHOQINA (*lë librin*). Njerëzit duhen shkundur. Edhe uji që është ujë, kur rri në një vend, qelbet. Pa të lëvrijnë njëherë! Sos është vetëm Tirana për punë e për jetë.

VASILIKA (*i merr filxhanin*) Ti, nënë, flet kështu, se s'të luan njeri. (*E shqetësuar.*) I thashë Filipit më telefono në çdo pushim. Po ai hiç. Kushedi si venë punët...

DHOQINA. Kishim një kryetar ne atje, një më dy bërtiste: punoj, e dua popullin, ia di hallet... Po populli ç'thoshte? Jo, moj nuse, populli s'e donte, pa e hoqi.

Vasilika shkon matanë. Dhoqina merr librin e lexon. Vasilika kthehet me një pako të mbështjellë.

VASILIKА (*duke hapur pakon*). Një copë stof nga ai i miri. E kisha ruajtur për ty.

DHOQINA. C'e do... Marga për Vit të Ri më dërgoi tamam një copë si kjo? Mbaje për vete.

VASILIKА. Ashtu? Nuk e do?

DHOQINA. C'ta dua?!

VASILIKА. Epo, kur s'e do... (*E lë mënjanë.*) Sa kemi rrojtur, s'do rrojmë, moj nënë. U rropatëm e punuam gjithë jetën për këtë cikëz rehat, me lutfët e me Partinë që në fillim u lidhëm.

DHOQINA (*lë librin*). Qeveria do punën, jo rehatin. Unë jam plakë dhe rehatin s'e dua. Atje, në fshat, edhe unë lëvrij. Shkoj nëpër mbledhje, punoj në depot e ullinjve. Puna më ka mbajtur gjallë.

VASILIKА. Kush është kundra punës? Unë dhe jashtë orarit punoj. Po Filipi? Lodhet, punon, këputet.

DHOQINA. Filipi s'ka zanat shkresat.

VASILIKA. Po edhe atë punë dikush duhet ta bëjë. (*Pauzë*). Po ti, moj nënë, nuk do të rrish me ne? Dhoma kemi plot. Dhe shtëpinë e mbajmë. Atje është rritur Etleva, bën dot çupa pa të?

Dhoqina ngrihet, shkon te dritarja.

Se paratë një grusht miza janë: mbyllur, e ke plot, e hap, s'mbetet asgjë.

DHOQINA. Shtëpinë nuk e mbaj, jo.

VASILIKA. Po pse, moj nënë? S'të lidh gjë me të?

DHOQINA (*rreptë*). Më lidh, s'më lidh, shtëpia nuk mbahet. S'jemi mësuar me dy shtëpi ne.

VASILIKA. Po jemi lidhur me shpirt, moj nënë!

DHOQINA. Sa e kam unë në zemër, s'e ke ti, moj nuse, po e lëmë tanë.

VASILIKA. Po shtyje shitjen dhe ca vjet, të paktën!

Pauzë e gjatë.

DHOQINA. Mbaroi, dhashë fjalën. (*Rreptë*) E shkoqita me Filipin. S'kemi ç'ta zgjasim më. (*Ulet në kolltuk, merr librin.*)

VASILIKA (*shfryn*). Mjerë ajo shtëpi në dorën e kujt do të bjerë!

Hyn Nora, lë violinën mbi divan, kërkon diçka në sirtarin e dollapit.

NORA (*Vasilikës*). Ku janë sandalet e reja? (*Kërkon.*)

VASILIKA. Pa mos më çaj kokën me gjithë sandale!

Nora e shikon të ëmën me habi.

DHOQINA. Ç'u vunua kjo? (Norës.) E pe Evën  
andej?

NORA (me të butë). Jo, gjyshe, nuk e pashë.  
(Del.)

Bie zilja e telefonit. Vasilika shkon me të shpejtë. Hyn  
Lluka, me hapa të ngadalëtë.

LLUKA. Si u ngryse, dadë e Markut?

DHOQINA. Mirë, more Llukë. E pe Etlevën  
andej?

LLUKA. Po vjen.

Hyjnë Etleva dhe Drita.

DRITA (hyn me të shpejtë, përqafon me mall  
Dhoqinën.) Gjyshe, si je? Më mori malli.

DHOQINA (e gëzuar). Dritë, mój çupë e gjyshes.  
Nga na vjen kështu?

DRITA. Erdhëm pér të parë ekspozitën me nxë-  
nësit. Ata u nisën, po unë do të rri sonte te tezja.

ETLEVA. Jo, jo. Sonte do të rrish këtu.

DRITA. Unë kisha një porosi nga fshati pér ty.

DHOQINA. Ç'porosi?

DRITA (e merr mënjanë). Ata të fshatit duan të  
blejnë shtëpinë tënde.

DHOQINA. Shtëpinë time? Po unë ia kam dhë-  
në fjalën Kasëmit.

DRITA. Ata e dinë, gjyshe. Biseduan me Kasë-  
min dhe ai pranoi. Puna-është se shtëpinë tënde duan  
ta bëjnë muze, duan ta zgjerojnë atë që është. Më

porositën të të them se punën e strehimit të Kasëmit do ta rregullojnë ata.

DHOQINA. Kështu? (Pauzë.) Kush të tha?

DRITA. Dhionisi, ai i këshillit.

DHOQINA (*mendohet*). Mirë. Kur do të ikësh ti?

DRITA. Nesër.

DHOQINA. Thuaju se kështu do të bëhet.

ETLEVA (*i afrohet*). Nxitojmë, gjyshe? Biletati gjeta, tri copë. (Llukës.) Llukë, ti do të kënaqesh atje.

LLUKA. Të më linin të thosha dhe unë ca vjersha.

Hyn Vasilika.

DRITA (*vë buzën në gaz, Vasilikës*). S'më njeh?

VASILIKA. Diku të kam parë, po...

ETLEVA (*Vasilikës*). Është Drita, mama, ajo mësuesja e Bregut që të kam folur.

VASILIKA. Ah, po, po...

ETLEVA. Eja, gjyshe, Llukë. (*Vasilikës*) Mama, po ikim. (*Dalin të katërt*.)

Hyn Nora.

NORA (*buzëvarur*). Fundi më është rrudhosur. Pse e kishe hequr nga varësja?

VASILIKA. Nora, më lër të qetë!

Nora i hedh një shikim të shpejtë dhe, pa folur, del.

(*Me vete*.) Na iku, na iku.... (*E helmuar*.) S'iu mbush që s'iu mbush mendja plakës. Ikën dhe ëndrrat. Ah, more Filip, që s'je pér asgjë! Ta hodhi yt vëlla, ta hodhi... (*E brengosur*.) Goxha shtëpi.... Të na prehej shpirti, me të gjitha të mirat... (Pauzë.) Sa keq, sa keq...

## Tabloja e nëntë.

Dhomë e apartamentit të Filipit.

Etleva merret me rregullimin e disa letrave të vizatimit teknik. Vasilika shkon e vjen nëpër dhomë. Nora luan në violinë një pjesë popullore. Hyn Dhoqina me rrobat e shtëpisë. Vasilika telefonon.

NORA. Gjyshe, të pëlqeu shfaqja? (*Lë violinën në divan.*)

DHOQINA (*ndez llullen*). Lëre mos e pyet. Në kënaqi. Fjalë shumë, po me brumë. Qesha me lot, brinjët me dorë i mbaja. Desh rashë përblys.

ETLEVA. Ti qeshje me zë të lartë, gjyshe. Njerëzit filluan të qeshnin me ty.

DHOQINA: C'kishin njerëzit me mua? Punën time kisha.

Hyn Vasilika me të shpejtë.

VASILIIKA. Mbledhja paska mbaruar dhe Filipi qenka nisur për këtu. (*Norës.*) Nora, më ndihmo të shtrojmë darkën.

NORA (*gjyshes*). Po Lluka? Lluka qeshte?

ETLEVA. Lluka bëri sikur donte të ngjitej në skenë, të përqafonte një aktor. (*Qesh.*) Një djalë i tha: xhaxha, nuk lejohet, dhe e mbajti nga xhaketa. C'kemi qeshur!

Bie zilja e derës.

VASILIIKA. Derën, Nora.

Nora shkon të hapë derën. Vasilika shkon matanë. Hyn Trifoni, i pasuar nga Lluka.

TRIFONI. Si u ngryse, nënë?

DHOQINA. Si jo më mirë.

TRIFONI. Filipi erdhi?

DHOQINA. Sa foli në tel. Duke ardhur është.

LLUKA. Ç'kemi parë ca numra në estradë sonte,  
o Trifon!

TRIFONI. Dhe sa ditë të mbetën, o Llukë?

LLUKA. Nesër iki. Më mori malli pér fshatin,  
Trifon.

Hyn Vasilika. Zilja e derës.

VASILIKА. Filipi...

Nora dhe Vasilika vrapojnë njëkohësisht pér të hapur de-rën, po përplasen duke dalë, Vasilika qëndron, Nora shkon e hap. Hyn Filipi e pas shpinës së tij hyn Nora.

(*I del përpara, me padurim.*) Hë?

Pauzë.

TRIFONI. Ç'u tha? Mbaroi?

FILIPI. (*Trifonit, i qetë*). Mbaroi. (*Norës.*) Dy  
gota ujë.

Nora del me të shpejtë.

VASILIKА. Po fol, more Filip!

FILIPI (*liron kravatën*). Epo, të marr frymë një-herë!

VASILIKА (*i shkon pranë*). Si s'më telefonove?!  
Unë prit e prit.

FILIPI. Epo, te ti e kisha mendjen! (*Trifonit.*)  
Mbaroi më së fundi, Trifon. Dy ditë mbledhje...

Hyn Nora, sjell një tabaka me dy gota.

ETLEVA. S'do të keni më seanca, baba?  
VASILIKA. Po hë? Si?

Filipi pi edhe gotën e dytë.

LLUKA. Uji benzinën e ndez më keq.

FILIPI. Mbaroi kjo punë, Trifon. Kërkova të qarkulloj.

VASILIKA (*me klithmë*). Si?! Të vunë në listë?

FILIPI. Nuk më vuri njeri në listë, po u ngrita vetë. (*Shkon te dritarja.*) U ngrita vetë.

VASILIKA (*i afrohet*). Vetë?! Jo, nuk je ngri-tur vetë, po s'do ta pranosh.

DHOQINA (*rreptë*). Pa prit ti, nuse! (*Filipit.*) Na e rrëfe nga fillimi.

FILIPI. (*kthehet nga ata*). Fillim e mbarim... (*Pauzë.*) Me një fjalë, vazhdimi i mbledhjes së organizatës bazë. Po aty kërciti e ç'kërciti... Kishte dhe të ftuar, kontrolli punëtor, gazetari... (*Pauzë.*) U tha-në gjérat copë: zvaritje, fryrje organikash, shkëputje nga baza... Kishte të meta edhe në nja dy degë të tjera, po si në degën tonë...

LLUKA. Degë më degë vete hardhia.

FILIPI. Mirë Llukë, mirë. (*Trifonit.*) Në seancën e tretë, për herë të parë e pasë Hysenin t'i dridhej mjekra... Të kam thënë, për fjalë është i zoti, po nuk i piu ujë. Fajet për çrregullimet u përpoq të m'i hidhte mua dhe Islamit. Kemi gabuar, Trifon, po kush djallin e kuptonte kur askush aty brenda-

përbrenda degës nuk të thoshte gjë? Na kritikonin shokët, na kritikonin nga baza, po kush ua vinte veshin, gjersa kishim shkuarje të mirë me njëri-tjetrin? Mjafton të bëje si thoshte Hyseni e pikë. Gabim na dukej të mos bënин si thoshte shefi... I dimë vetë punët tona ne, thoshte ky...

TRIFONI. Posi, posi. Ju i dinit...

FILIPI. Që ta them shqip, s'donim ta prishnim me Hysenin, dhe Hyseni bënte si donte vetë. Kur vinte puna për të dhënë llogari, nuk e di, po i ecte, shkiste... E kritikonin edhe paq, po pas mbledhjes, për çudi, Hyseni mbetej ai që ishte... (*Me zë të ulët.*) Këto vijnë nga besimi i tepruar, Trifon. Dhe ja, vjen një ditë që gjërat trashen...

TRIFONI. Bjeri më shkurt. Ti ç'the?

FILIPI. U ngrita e fola. Zbërtheva punët e mia, të degës, të Hysenit. (*Pauzë.*) Po, ç'është e vërteta, s'ishte puna vetëm te Hyseni, ne të tjerët s'ishim më pak të larë. Oportunizmi, doli atje, është bashkëfa-jësi. (*Pauzë.*) Ndërsa flisja, Hyseni u ngrit nga dy herë e ma preu fjalën, po herën e tretë gazetari dhe ata të kontrollit punëtor e vunë me shpatulla pas muri me fakte. As gëk as mëk. (*Pauzë.*) Nuk e di, Trifon, po ndërsa flisja, ndieja se një grumbull i tërë shqetësimesh, të kaq viteve me radhë, po e humbiste kuptimin... (*Pauzë.*) I pranova gabimet. (*Pauzë.*) Si mbarova, kërkova të qarkulloj.

DHOQINA. Të ishe ngritur i pari! Para Hysenit të flisje. (*Ngre zérin.*) Partia ju vë për punë, ju na ndërtuaki çerdhe dallëndysheje...

FILIPI (Dhoqinës). Po kush e dinte, moj nënë, se ç'dhelpër ishte ai...

DHOQINA (*rreptë*). Ta dije ti! Të mos kishe

dremitur! Se je i biri i Polos dhe vëllai i Markut! Se e ke pushtetin tëndin.

ETLEVA (*shpejt*). Mirë thotë gjyshja, baba. Të ishe ngritur i pari. Po prapëseprapë... nuk ke përse të shqetësohesh.

VASILIKA. Mbylle ti! Ti e ke gjithë jetën përpara, po unë e yt atë s'jemi një me ty. More vesh?

ETLEVA (*e vendosur*). Është për të ardhur keq, mama, po ti kështu e ke parë jetën gjithmonë... Brenda mureve, e shkëputur nga bota, vetëm për vete e shtëpinë tënde... Sipas teje, asgjë nuk është e mirë për ty.

VASILIKA. Të shohim si do të mendosh ti në të ardhmen.

ETLEVA. Kurrë vetëm për vete! Ti e di shumë mirë se ne, si klasë, qysh para stazhit kemi vendosur të punojmë atje ku ka nevojë atdheu.

VASILIKA. Atje ku të shërbën burri...

LLUKA. Epo, gruaja dhe burri, pe' e gjilpërë.

DHOQINA. Bukuri! Hajdeni të hamë darkë tanë.

VASILIKA (*i afrohet Filipit*). Po mirë, nuk e morën parasysh autokritikën tënde?

FILIPI (*nxehet*). Autokritika, në radhë të parë, bëhet me punë. (*Trifonit, ultas*). Vetëm një merak më mundon, Trifon.

TRIFONI. Ç'merak?

FILIPI. Ma thuaj hapur, Trifon, do t'ia filloj dot nga e para?

TRIFONI. Po pse do t'ia fillosh nga e para, o Filip!

LLUKA. E ka këtu, o Trifon: ka pluhur për të shkundur a ndryshk për të grryer?

ETLEVA (*i shkon të atit pranë*) Po, baba. Ti nuk do ta kesh të vështirë...

FILIPI. Etlevë, moj bijë... (*I ngecin fjalët.*)

VASILIKА. Kérko të shkojmë në qytet, të paktën...

TRIFONI. Kudo ku ka njerëz, ka nevojë për Filipin, Vasilikë!

VASILIKА (*Filipit*). Po qe për në fshat, kérko në fshatin tënd. Shtëpinë gati e kemi. (*Urdhëruese.*) Nëna s'ka pse ta shesë shtëpinë tanë.

FILIPI. Na plase me shtëpinë! (*Pauzë e shkurtër.*) Ta thyejmë kërrabën, moj grua, se e kemi zgjatur si shumë! Se shtëpia s'na takon fare! Se u vëçuan nga njerëzit! Se na mori malli të bëjmë një muhabet me zemër e kripë...

VASILIKА. Filip...

DHOQINA (*ndezi llullën*). Nusja bëri mirë që na e kujtoi. Ju kam thënë se kullën e Bregut do ta shes, po sonte m'u kthyen mendja.

VASILIKА. E shjhni?

DHOQINA (*rreptë.*) Mos nxito! Nevojë për para s'kam, shkoj me djemtë a me çupat, dhe ata pa shtëpi s'janë.

VASILIKА (*me triumf*). E sheh, Trifon?

DHOQINA (*ngadalë*). E, meqë m'u kthyen mendja e nuk do ta shes, do t'ia fal Markut.

VASILIKА. Markut?!

DHOQINA. Kulla e Bregut i takon Markut dhe atij ia kam dhënë.

VASILIKА (*si me vete*). Lajthiti kjo?

DHOQINA. Markut, trimit të nënës. Markut, që dha jetën në lule të rinisë për këtë truall. Shtëpinë ia fala Markut dhe shokëve të tij, që m'iu bëftë nënëia.

TRIFONI (*që s'kupton*). Si është puna, moj nënë?

DHOQINA. Më thotë Drita qëparë se kanë dërguar fjalë ata të fshatit. Duan ta blejnë shtëpinë tonë për muze. Ai që kemi, qenka i vogël. Dhe unë u menduash... (*Pauzë.*) Shtëpia nuk i shitet djalit. (*Pauzë.*) Partia na ka dhënë shtëpitë tona. Atyre që s'u ka dhënë, do t'u japë.

Pauzë.

TRIFONI (*i rreh shpatullat*). Ç'të shkoi mirë në mend, nënoke! (*I gëzuar.*) Ky është nder për ne. (*Filipit.*) Apo jo, Filip?

FILIPI. Po, Trifon. (*Tepër i menduar, si me vete.*) Marku kurrë nuk do të kishte dashur që ne ta 'mbanim atë shtëpi...

Bie fort zilja e derës, po askush nuk shkon ta hapë.

ETLEVA. Sa mirë e the, baba! (*I shkon pranë, i kap dorën, zilja vazhdon të bjerë. Shkon me vrap pëtë hapë derën, e hap, e gëzuar.* Agroni... (*Thérret.*) Erdhi Agroni! (*Me fytyrë nga dera.*) Agron!

F U N D